



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 74

10 maj

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 123/2013 datë 25.4.2013	Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërisë “Rapiscan Security, INC.”, si koncesionar, për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit 3191
Vendim i Kuvendit nr. 26/2013, datë 29.4.2013	Për ngritjen e komisionit hetimor dhe caktimin e objektit, përbërjes dhe afatit të veprimtarisë së tij për hetimin e fakteve, rrethanave dhe përgjegjësisë të incidentit të datës 24 prill 2013 pranë Akademisë Diplomatike të Vjenës 3223
Vendim i Kuvendit nr. 27/2013, datë 29.4.2013	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Artan Broci anëtar i Gjykatës së Lartë 3224
Vendim i Kuvendit nr. 28/2013, datë 2.5.2013	Për lirimin nga detyra të një anëtari dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 3224
Vendim i Kuvendit nr. 29/2013, datë 2.5.2013	Për lirimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare 3225
Vendim i Kuvendit nr. 30/2013, datë 2.5.2013	Për lirimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare 3225
Vendim i Kuvendit nr. 31/2013, datë 2.5.2013	Për lirimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare 3226
Vendim i Kuvendit nr. 32/2013, datë 2.5.2013	Për lirimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 3226

Vendim i Kuvendit nr. 33/2013, datë 2.5.2013	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.....	3227
Vendim i Kuvendit nr. 34/2013, datë 2.5.2013	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	3227

LIGJ
Nr. 123/2013

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË
FINANCIVE, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE SHOQËRISË “RAPISCAN SECURITY,
INC.”, SI KONCESIONAR, PËR FINANCIMIN, NGRITJEN DHE OPERIMIN E SHËRBIMIT
TË SKANIMIT TË KONTEJNERËVE E AUTOMJETEVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË DHE TARIFËS SË SHËRBIMIT TË SKANIMIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet kontrata e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërisë “Rapiscan Security INC.”, si koncesionar, për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera.

Neni 2

Tarifa e shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera është në vlerën 39 euro (pa përfshirë TVSH-në). Shërbimi i skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera trajtohet si furnizim i tatueshëm me TVSH me shkallë tatimore 0 (zero).

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8143, datë 2.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE KONCESIONI

Kjo Marrëveshje Koncesioni (“Marrëveshja” ose “Kontrata”) është lidhur dhe nënshkruar që nga 10 prilli 2013, midis Ministrisë së Financave, duke vepruar për llogari të Republikës së Shqipërisë sipas autorizimit dhënë nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 2.11.2011, referuar si “Autoriteti”, e përfaqësuar nga Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë, z. Ridvan Bode dhe Rapiscan Systems, INC. (në vijim referuar si “Rapiscan”), me numër 954-41-3488, shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Kalifornisë, USA, në vijim përfaqësuar nga Jonathan Fleming, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, zëvendëspresident i Rapiscan dhe banues në Commonwealth Virginia, USA.

PREAMBULA

Ndërkohë që, me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 755, datë 2.11.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonuseve të shoqërisë”, Këshilli i Ministrave caktoi Ministrinë e Financave të



Republikës së Shqipërisë si Autoritetin Kontraktues për dhënie me koncesion të shërbimit për “Skanimin e kontejnerëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë”;

Ndërkohë që Autoriteti paraqiti një kërkesë për propozime më 2012-në (në vijim “RFP”) për një marrëveshje koncesioni për të siguruar një zgjidhje përfundimtare me çelësa në dorë për Autoritetin për skanimin e kontejnerëve dhe automjeteve të tjera në pikat e hyrjes dhe të daljes në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i shërbimeve dhe i aspekteve të tjera të lidhura me projektin përcaktohen në RFP;

Ndërkohë që Rapiscan i paraqiti Autoritetit një propozim në përgjigje të RFP (propozimi), duke parashtruar propozimin për të siguruar shërbimet e përmendura në RFP (shërbimet e përcaktuara);

Ndërkohë që Rapiscan u përzgjedh si fitues si rezultat i procesit të vlerësimit si pasojë e përmbushjes së kërkesave të specifikuar në RFP në përputhje me përcaktimet e bëra nga Autoriteti;

Ndërkohë që, duke u mbështetur në kompetencat e tij, Autoriteti dëshiron që të pajtojë Rapiscan për ofrimin e shërbimeve të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera në pikat e hyrjes dhe daljes të Republikës së Shqipërisë;

Si pasojë, duke konsideruar zotimet e palëve dhe marrëveshjet reciproke të përcaktuara në këtë Kontratë, palët bien dakord si më poshtë:

TERMAT DHE KUSHTET

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

Për qëllimet e kësaj Kontrate, fjalët dhe frazat në vijim do të kenë kuptimet si më poshtë vijon:

1.1 “Ligji i zbatueshëm” do të thotë çdo ligj, statut, urdhër, kod, rregull, rregullore të Republikës së Shqipërisë dhe çdo urdhër, vendim gjykate, urdhër gjyqësor, dekret, urdhëresë, përcaktim, titull, leje ose akt të çdo organi shtetëror, aktualisht në fuqi ose që mund të vijë në fuqi në të ardhmen, ose çdo marrëveshje tjetër detyruese të çdo organi shtetëror, përfshirë standardet teknike, kodet dhe specifikimet të kërkuara për profesionet e veçanta.

1.2 “Informacion konfidencial” do të thotë çdo informacion i përcaktuar si konfidencial (ose nëse është dhënë me gojë, ndiqet brenda tri ditësh pune nga një njoftim me shkrim nga dhënësi i informacionit, duke përshkuar informacionin konfidencial të dhënë në këtë mënyrë) dhe që merret nga përfituesi i informacionit të dhënë nga dhënësi i informacionit, ose çdo filial i dhënësit të informacionit, ose nga avokati i dhënësit të informacionit ose çdo agjent tjetër, në çdo formë transmetimi, të lidhur me veprimtarinë e dhënësit të informacionit, veprimtarinë tregtare, punët ose pasuritë, përfshirë, por jo vetëm, teknologjitë, kërkimet dhe zhvillimet, planet e biznesit, sekretet tregtare dhe sistemet. Informacionet konfidenciale nuk do të përfshijnë informacione, të cilat: i) bëhen publike jo si rezultat i shkëljes së kësaj Marrëveshjeje nga palët; ii) u janë bërë të ditura palëve përpara kësaj Kontrate; iii) janë përfituar individualisht nga palët pa shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje; ose iv) janë kërkuar të bëhen publike nga ligji ose nga një proces gjyqësor.

1.3 “Balancë të papaguar” u referohet rasteve nëse Rapiscan nuk është paguar nga Autoriteti për çdo skanim të kryer për një periudhë që tejkalon tridhjetë (30) ditë.

1.4 “Data ekzekutimit” do të thotë data e nënshkrimit të Marrëveshjes.

1.5 “Organ shtetëror” do të thotë Republika e Shqipërisë, bashkitë e saj, instrumentet ose çdo ligj, rregull ose urdhër, të miratuar nga Parlamenti Shqiptar, Qeveria e Shqipërisë dhe agjencitë e saj të cilat kanë juridiksion mbi Autoritetin, Rapiscan ose një nënkontraktues.

1.6 “Humbjet dhe shpenzimet” do të thotë çdo humbje aktuale, detyrimet, penalizimet, dëmet (duke përfshirë dëmet madhore, të cilat do të përfshijnë humbjet ose fitimet, të ardhurat, mundësitë, përdorimet dhe emrin e mirë), gjambat, paditë, procedurat gjyqësore, penaltitetet, gjykimet, zgjidhjet jashtëgjyqësore, depozitat, akuzat, taksat, kostot ose shpenzimet, përfshirë të gjitha gjambat dhe kostot e arsyeshme të shkaktuara në lidhje me investigimin, përgatitjen, mbrojtjen ose përgjigjen e duhur ndaj çdo procedure ligjore.

1.7 “Specifikimet e performancës operuese” do të thotë standardet e performancës së pajisjeve, në aspektin e sasisë dhe cilësisë së skanimit dhe raportit të xhiros, përcaktuar në parametrat e performancës, paraqitur në shtojcën A.

1.8 “Data e fillimit të operimeve” do të thotë data kur Rapiscan siguron Autoritetin se vendi i parë për operimin do të jetë gati në përputhje me seksionin 9.5 dhe do të fillojë jo më shumë se tetë muaj pas datës efektive, kushtëzuar kjo me bashkëpunimin e duhur të Autoritetit, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje. Rapiscan garanton Autoritetin për fillimin e operimit dhe kjo garanci do të bashkëngjitet në këtë Kontratë duke përbërë datën e fillimit të operimeve.

1.9 “Propozimi” do të thotë propozimi i paraqitur nga Rapiscan në përgjigje të RFP, bashkëngjitur në këtë Marrëveshje si shtojca D.

1.10 “Vendi” do të thotë një nga pesë vendet në Shqipëri, ku do të kryhen shërbimet e përcaktuara.

1.11 “Vend i përhershëm” do të thotë një vend i specifikuar si i tillë nga Autoriteti dhe Rapiscan në përputhje me termat e kësaj Kontrate.

1.12 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person (përveç punëmarrësve të Rapiscan) të përfshirë në Marrëveshje ose të kontraktuar nga Rapiscan, të çdo niveli, për përmbushjen e detyrimeve të Rapiscan, ose për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Kontrate, ose në formën e shërbimeve, materialeve, pajisjeve, ose punës, përfshirë agjentët, konsulentët ose nënkonsulentët, në konfidencialitet ose jo me Rapiscan.

2. KONTRATA NË TËRËSI.

Kjo Kontratë zëvendëson çdo kontratë tjetër, me shkrim ose me gojë, midis palëve dhe përfshin të gjitha dakordësitë dhe marrëveshjet mes palëve të kësaj Kontrate në lidhje me objektin e saj. Midis palëve të kësaj Kontrate, ose çdo personi që vepron për llogari të palëve, nuk është bërë asnjë përfaqësim, zotim, nxitje ose kontratë me gojë ose në ndonjë mënyrë tjetër, përveçse atyre të përfshira dhe përmendura në këtë Kontratë dhe asnjë kontratë, deklaratë apo zotim tjetër, që nuk përfshihet në këtë Kontratë nuk do të jetë detyrues apo i vlefshëm. Çdo modifikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm vetëm nëse bëhet me anë të një kontrate amendimi të nënshkruar sipas ligjit nga palët e kësaj Kontrate dhe nuk është i nevojshëm miratimi i parlamentit të Republikës së Shqipërisë. Pavarësisht paragrafit të mësipërm, modifikimet në këtë Kontratë lidhur me çmimin, qëllimin e shërbimeve, kohëzgjatjen, tarifën koncesionare, forcën madhore, humbjen dhe shpenzimet mund të krijojnë efekt vetëm nëse ato janë miratuar nga parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

3. INTERPRETIMI DHE PËRPARËSIA.

RFP dhe propozimi janë të përfshira si pjesë përbërëse e kësaj Kontrate. Në rast të çdo konflikti ose mospërputhshmërie midis termave të përcaktuar në këtë Kontratë (trupi i Kontratës), termave të përcaktuar në RFP dhe termave në propozim, Kontrata do të ketë përparësi mbi çështjet shprehimisht të rregulluara nga Kontrata.

RFP dhe propozimi mund të përdoren nga palët gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate në masën e nevojshme për interpretimin e qëllimeve të palëve kontraktuese. Për sa kohë që një çështje nuk është trajtuar shprehimisht në Kontratë ose në RFP, për të përcaktuar qëllimin e palëve do të ketë prioritet sipas radhës:

1. RFP;
2. Propozimi;
3. Kontrata.

4. KOHËZGJATJA

4.1 Kohëzgjatja (kohëzgjatja) e kësaj Marrëveshjeje do të fillojë në datën efektive dhe do të mbarojë në përvjetorin e pesëmbëdhjetë (15) të certifikatës së Rapiscan, në përputhje me seksionin 9.5, të të pesta vendeve gati për operim.

4.2 Rapiscan mund t'i kërkojë Autoritetit zgjatjen e kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje me paraqitjen e një Kërkesë me shkrim para Autoritetit (njoftimit) për zgjatjen e kohëzgjatjes së kësaj



Marrëveshjeje përgjatë ose para mbarimit të përvjetorit të 12-të të datës efektive. Autoriteti do të njoftojë Rapiscan për vendimin e saj nëse do të miratojë zgjatjen e Marrëveshjes brenda njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh nga marrja e njoftimit.

4.3 Në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian ose në çdo kohë pas këtij anëtarësimi, Autoriteti do të ketë të drejtë të kërkojë rishikimin e kësaj Kontrate në mënyrë të tillë që të sigurojë përputhjen në mënyrë të plotë me kriteret e detyrueshme për anëtarësim të Bashkimit Europian. Nëse, për sa më sipër, Autoriteti vendos të ndryshojë këtë Kontratë, Rapiscan do të ketë të drejtë, pa paragjykuar ndonjë të drejtë tjetër të ofruar nga ligji, të zgjidhë këtë Kontratë pa pësuar ndonjë penalitet ose pasojë ligjore përkundrejt Autoritetit.

4.4 Ashtu siç përmendet në këtë Marrëveshje, termi “kohëzgjatje” do të thotë kohëzgjatja dhe si e tillë mund të zgjatet në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate herë pas here.

5. DETYRIMET E RAPISCAN

5.1 Brenda 30 ditëve nga data efektive, Rapiscan do të themelojë një shoqëri (shoqëri) në Shqipëri me objekt të vetëm biznesi ofrimin e shërbimeve të përcaktuara. Me themelimin e shoqërisë, kjo Marrëveshje do të transferohet në tërësi te shoqëria në mënyrë të tillë që detyrimet e Rapiscan sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë vetëm detyrimet e shoqërisë. Pavarësisht fjalisë së mësipërme, Rapiscan do të veprojë si garantues në lidhje me të gjitha detyrimet që do t'i transferohen shoqërisë në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Kontrate, për gjithë kohëzgjatjen e kësaj Kontrate.

Çdo transferim i kuotave brenda shoqërisë do të kushtëzohet nga miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktues, miratim ky që nuk mund të vonohet ose të mbahet në mënyrë të paarsyeshme; përveç rasteve të mëposhtme në të cilat transferimi do të kryhet vetëm me njoftimin e Rapiscan para Autoritetit: a) transferimi i kuotave te një filial i Rapiscan; dhe b) transferimi deri në 24% të interesit në shoqëri të çdo pale.

5.2 Shoqëria ka detyrimin:

5.2.1 të përmbushë planin e biznesit në përputhje me propozimin;

5.2.2 të kryejë investimin sipas afatit të parashikuar në përputhje me propozimin dhe të arrijë cilësinë e kërkuar;

5.2.3 të drejtojë dhe të administrojë sistemin e skanimit gjatë kohëzgjatjes;

5.2.4 të mbulojë dëmet e shkaktuara palëve të treta për faj të tij;

5.2.5 të informojë Autoritetin Kontraktues për situatat e njohura që mund të ndikojnë ndjeshëm dhe negativisht në zbatimin e projektit të koncesionit;

5.2.6 të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar gjatë aktivitetit të saj;

5.2.7 të marrë masat për garantimin e kushteve të sigurisë në punë, për punëmarrësit dhe personat e tjerë, të shmangë dëmin e pronës private dhe shtetërore, si dhe të zbatojë legjislacionin në lidhje me parandalimin e dëmtimeve dhe fatkeqësive në vendin e punës.

5.2.8 të ofrojë, nënshtruar klauzolës 7.3 më poshtë, shërbime në përputhje me planin kohor të zbatimit, siç është përcaktuar në shtojcën C;

5.2.9 të lidhet me serverin ose *switchin* lokal më të afërt të vendit të Autoritetit, siç mund të jetë rasti për qëllimet e transferimit të imazheve dhe analizimin e të dhënave të tyre;

5.2.10 të sigurojë trajnim për analizimin e imazheve të doganierëve shqiptarë të caktuar nga Autoriteti.

6. VENDET

Vendet do të caktohen nga Autoriteti në bashkëpunim me Rapiscan. Palët bien dakord se vendet do të jenë të përshtatshme në mënyrë të arsyeshme për kryerjen normale të shërbimeve të përcaktuara, të sheshta, të qëndrueshme dhe të ndërtueshme dhe me përmasa të paktën 70 metra me 40 metra, të pozicionuara dhe të orientuara në mënyrë të tillë që të garantohet hyrja dhe dalja e duhur e kontejnerëve dhe automjeteve për inspektim. Autoriteti mund të kërkojë, pas dhënies Rapiscan së një njoftimi me shkrim të paktën 15 ditë kalendarike, që Rapiscan të zhvendosë skanerët

e lëvizshëm M60 në një vend tjetër për një periudhë jo më të gjatë se 90 ditë kalendarike, me kusht që Rapiscan do të ketë të drejtë të ndërpresë shërbimet e përcaktuara për t'u ofruar nga një skaner i tillë i lëvizshëm M60 për një periudhë jo më të gjatë se 5 ditë në lidhje me një zhvendosje të tillë. Për shmangien e dyshimeve vetëm dy skanerë të lëvizshëm M60 mund të zhvendosen në çdo kohë të dhënë dhe çdo detyrim i pagueshëm për Rapiscan nuk do të ndikohet për shkak të ndërprerjes së shërbimeve të përcaktuara lidhur me shkaqet e përcaktuara në fjalinë e mësipërme.

7. ANGAZHIMI DHE TË DREJTAT PËR PËRDORIMIN E VENDEVE

7.1 Angazhimi. Autoriteti me anë të kësaj Kontrate angazhon Rapiscan për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje për të siguruar zbatimin e projektit, dizenjimin, testimin dhe operimin e sistemit, duke ofruar shërbimet e përcaktuara dhe transferimin e vendeve dhe pajisjeve tek Autoriteti mbas mbarimit të kohëzgjatjes në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Kontrate. Detyrimet e Rapiscan për të siguruar skanimin e kontejnerëve do të limitohet vetëm brenda vendeve dhe shërbimeve të përcaktuara.

7.2 Dhënia e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme. Pa asnjë kosto të Rapiscan: a) Autoriteti do t'i japë Rapiscan vendet në përdorim të kësaj të fundit, si dhe aksesin, të drejtën e përdorimit dhe kontrollin e vendeve deri në masën që është e nevojshme për kryerjen në mënyrë të arsyeshme të shërbimeve të përcaktuara; b) Rapiscan do të ketë, gjithashtu, të drejtën e hyrjes dhe të daljes në dhe nga vendet, përfshirë transportin e pajisjeve dhe të mirave të tjera të nevojshme për dhënien e shërbimeve të përcaktuara. Pavarësisht paragrafit të mësipërm, Rapiscan do të marrë përsipër çdo kosto që në mënyrë të arsyeshme do t'i vinte Autoritetit për qëllime të pagesës së çmimit të shpronësimit për tokën, e cila do të përdoret për vendet në përputhje me legjislacionin në fuqi në lidhje me shpronësimin për interes publik në Republikën e Shqipërisë. Palët pranojnë se kostoja që Rapiscan mund t'i kërkohej që të marrë përsipër sipas kësaj Kontrate nuk parashikohet të jetë më shumë se 100.000 euro.

7.3 Autoriteti pranon se ofrimi nga ana e tij në kohë dhe në mënyrë të rregullt: a) akses në shërbimet nevojshme; dhe b) vendet në një gjendje të gatshme për ndërtimin dhe instalimin e punimeve civile dhe sistemeve të Rapiscan, është thelbësore për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara. Autoriteti merr përsipër të sigurojë vendet: i) brenda 45 ditëve nga data efektive referuar vendeve ku shpronësimi nuk kërkohej ose nuk është i nevojshëm për t'u bërë; dhe ii) brenda 5 ditëve nga koha që shpronësimi është kryer, por në çdo rast, jo më shumë se tetë (8) muaj nga data efektive referuar vendeve ku shpronësimi është i nevojshëm. Për shmangien e çdo dyshimi, Autoriteti, brenda afateve të përmendura më lart, duhet të sigurojë të gjitha dokumentet, miratimet apo aprovimet, siç mund të kërkohej nga një pronar toke në lidhje me marrjen e të gjitha lejeve për ndërtimin dhe instalimin e punimeve civile dhe sistemeve të Rapiscan në lidhje me vendet. Detyrimi i Rapiscan për të filluar ndërtimin nuk do të nisë para se të gjitha lejet e nevojshme dhe pëlqimet të jenë marrë në lidhje me ndërtimin dhe instalimin e punimeve civile dhe sistemeve të Rapiscan.

7.4 Bashkëpunimi nga ana e Autoritetit përfshin: a) specifikimin e vendeve brenda 30 ditëve pas datës efektive; b) pas përcaktimit të vendeve, aksesin mbi të gjitha këto vende në mënyrë të tillë që Rapiscan të ketë mundësinë të kryejë punimet e nevojshme civile, si dhe instalimin e sistemeve; c) brenda 60 ditëve pas përcaktimit të vendeve, duke bërë përpjekjet e tij më të mira, të mundësojë marrjen e elektricitetit në të gjitha vendet dhe të sigurojë që Rapiscan dhe kontraktorët e tjerë do të kenë akses të nevojshëm te vendet për lëvizjen e makinave dhe këmbësorëve për punëtorët dhe shpërndarjen e impianteve, materialeve dhe pajisjeve të tjera; dhe d) të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të ndihmuar Rapiscan, brenda 30 ditësh nga kërkesa e Rapiscan, të përftojë të gjitha lejet dhe miratimet e nevojshme sipas legjislacionit të zbatueshëm për ndërtimin dhe instalimin e punimeve civile dhe sistemeve (përfshirë pa kufizim çdo leje apo miratim ndërtimi, leje për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë, leje mjedisore dhe leje apo miratime të tjera, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e punimeve civile dhe sistemeve në përputhje me propozimin), si dhe lejet, licencat apo miratimet e çdo lloji për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara (për shembull, lejet e



punës dhe licencat apo lejet e ndotjes radioaktive), në mënyrë të tillë që asnjë prej vendeve të mos i mungojë ndonjë aprovim qeveritar me qëllim ndërtimin apo bërjen e tyre funksionale. Në rast të vonesës së bashkëpunimit nga Autoriteti, pa paragjykuar ndonjë të drejtë tjetër të ofruar nga ligji apo kjo Marrëveshje, afati kohor për Rapiscan për përmbushjen e çdo detyrimi ende të papërmbushur sipas kësaj Marrëveshjeje do të zgjatet në kohë sipas kohëzgjatjes së kësaj vonese. Për shmangien e çdo dyshimi, Rapiscan do të jetë e vetme përgjegjëse për të aplikuar dhe për t'u siguruar që ajo i ka të gjitha lejet e nevojshme dhe/ose licencat dhe autorizimet siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë herë pas here.

7.5 Qëllimi i të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme. Rapiscan do të përdorë vendet vetëm për qëllimin e kryerjes së shërbimeve të përcaktuara dhe do të ndër marrë të gjitha veprimet karakteristike lidhur me ofrimin e shërbimeve të përcaktuara.

7.6 Prona personale. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, të drejtat e pasurive personale të ofruara nga Rapiscan përfshirë të gjitha pajisjet do t'i mbeten Rapiscan. Asnjë pajisje nuk do të konsiderohet si përmirësim i vendit ose një objekt fiks në asnjë rrethanë. Në përfundim të kohëzgjatjes, e drejta mbi pajisjet do t'i transferohet Autoritetit.

7.7 Siguria. Autoriteti do të ofrojë një siguri të tillë, nëse është e nevojshme, për sigurinë e vendeve dhe personelit të Rapiscan, nënkontraktuesve dhe agjentëve të saj, ashtu siç e ofron një siguri të tillë për vendet dhe personelin e saj në zonat respektive. Rapiscan do të jetë e vetme përgjegjëse për çdo humbje apo dëmtim të pajisjeve dhe pasurive të saj.

8. PAJISJET

8.1 Pajisjet. Gjatë kohëzgjatjes, Rapiscan bie dakord të kryejë shërbimet e përcaktuara duke përdorur pajisjet e përmendura në shtojcën A (këto pajisje së bashku me të gjitha zëvendësueset dhe përfshirë punimet civile dhe sistemet e lidhura me to, referohen bashkërisht si "pajisjet") sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje. Gjata gjithë kohëzgjatjes të gjitha pajisjet do të mbeten pronë e Rapiscan.

8.2 Mirëmbajtja e pajisjeve. Gjatë kohëzgjatjes, Rapiscan do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve në kushte të mira operuese dhe të arsyeshme dhe në përputhje me specifikimet e performancës operuese siç përcaktohet në shtojcën A. Rapiscan rezervon të drejtën për të modifikuar dizajnimin dhe specifikat e pajisjeve, me kusht që modifikimi, sipas arsyesimit të logjikshëm të Rapiscan, nuk ndikon negativisht operimin e pajisjes. Rapiscan ka të drejtën të zëvendësojë çdo komponent ose pjesë të pajisjes me një pjesë të dobishme funksionale të një niveli të barabartë ose më të lartë të efektshmërisë. Përditësimet e software-ve do të bëhen çdo gjashtë muaj dhe zëvendësimin me të reja të pajisjeve dhe komponentëve do të bëhet çdo pesë vjet. Rapiscan do të mbajë rezervë pjesët e këmbimit në vendet e përhershme. Përveç kësaj, një inxhinier me shërbim në terren do të jetë në çdo vend çdo ditë që të mirëmbajë në mënyrë të vazhdueshme pajisjet dhe të jetë në gjendje për t'iu përgjigjur çdo shërbimi të nevojshëm, brenda afateve kohore të përcaktuara në shtojcën B.

8.3 Zëvendësimi i pajisjeve. Në mënyrë që të arrihet një përputhshmëri sa më e mirë me specifikimet e performancës operuese, dhe/ose në zgjedhjen e saj të vetme, Rapiscan mund të largojë pajisjet nga vendet rast pas rasti gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, me kusht që Rapiscan të zëvendësojë këto të fundit në mënyrë të menjëhershme me pajisje të së njëjtës përmasë, lloj dhe material me pajisjet e larguara dhe Rapiscan do të njoftojë paraprakisht Autoritetin.

8.4 Pronësia. Pronësia mbi pajisjen do të mbetet te Rapiscan gjatë gjithë kohëzgjatjes dhe Autoriteti bie dakord të mos ngrejë asnjë pretendim të mos kryejë asnjë veprim apo të mos bëjë asnjë deklaratë për heqjen e pronësisë së pajisjeve nga Rapiscan. Gjatë kohëzgjatjes, Autoriteti do të mbajë pajisjen të lirë dhe të çliruar nga çdo peng, barrë apo pretendim të çdo lloji. Pas përfundimit të kohëzgjatjes, pronësia mbi këto pajisje, që janë të nevojshme për vendet për të operuar në mënyrë të plotë, do t'i kalojë Autoritetit. Për shmangien e dyshimeve, Rapiscan nuk ka detyrim të transferojë tek Autoriteti pronësinë mbi ndonjë pajisje, e cila mund të ndodhet në ndonjë vend në

përfundim të kohëzgjatjes, por që Rapiscan nuk kishte detyrimin për ta pasur në atë vend.

8.5 Kontrolli dhe posedimi i pajisjeve. Rapiscan do të ketë të drejtën ekskluzive të kontrollit dhe të posedimit të pajisjeve, përfshirë të drejtën për të zhvendosur pajisjen nga vendet në rast të përfundimit të Marrëveshjes para afatit. Gjatë kohëzgjatjes, Autoriteti nuk do të përdorë, të operojë me ose të lejojë çdo palë të tretë të përdorë pajisjet pa marrë miratimin paraprak me shkrim nga Rapiscan.

8.6 Siguracioni. Gjatë kohëzgjatjes, Rapiscan duhet të ketë siguracionin e duhur.

8.7 Raportet. Gjatë kohëzgjatjes, Rapiscan do të paraqesë para Autoritetit raporte mujore, duke përshkruar gjendjen e shërbimeve.

8.8 Garanci të tjera. Autoriteti do të ekzekutojë dhe do të pajisë Rapiscan me kërkesën e këtij të fundit, me dokumente, instrumente dhe garanci të tjera të vlerësuara si të nevojshme nga Rapiscan për të parandaluar, mbrojtur dhe përsosur të drejtën ose interesin e Rapiscan mbi pajisjet. Autoriteti autorizon Rapiscan për të regjistruar apo për të dorëzuar këto dokumente, instrumente dhe garanci në lidhje me pajisjet pa nënshkrimin e Autoritetit të vlerësuara si të nevojshme nga Rapiscan për të parandaluar, mbrojtur dhe përsosur të drejtën ose interesin e Rapiscan mbi pajisjet.

9. SHËRBIMET

9.1 Shërbimet. Rapiscan do të ofrojë një zgjidhje të integruar skanimit mallrash, e cila përfshin zbatimin, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen e infrastrukturës dhe mundësimin e komponentëve të pajisjeve të skanimit jodepërtuese me rreze *x-ray*. Përveç kësaj, Rapiscan do të kryejë analizimin, vlerësimin dhe transferimin lokal të imazheve në objektin doganor të afërt. Rapiscan do të sigurojë vetëm shërbimet e përcaktuara, siç përcaktohen më poshtë në këtë seksion 9.1.

Shërbimet e përcaktuara do të jetë si më poshtë:

1. Rapiscan do të mundësojë projektimin, ndërtimin, instalimin dhe mirëmbajtjen të pesë vendeve plotësisht të integruara, duke përdorur Rapiscan Eagle 6 MeV një pajisje skanimit jodepërtuese me rreze *x-ray* (G60 ose M60) brenda kohëzgjatjes së Kontratës.

2. Rapiscan do të punësojë dhe do të trajnojë stafin për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen, sigurinë e vendeve dhe analizimin e të gjitha imazheve të prodhuara nga pajisjet e skanimit jodepërtuese me rreze *x-ray*. Analizimi i imazheve do të kryhet në vendet, duke përdorur Rapiscan “Cargo Viewer” software.

3. Rapiscan do të menaxhojë procesin e përpunimit lokal, ruajtjes lokale dhe transferimit lokal të të dhënave në një vend doganor të afërt, si dhe software për të lejuar inspektimin lokal dhe analizimin e imazheve të prodhuara nga pajisjet e skanimit Rapiscan jodepërtuese me rreze *x-ray*.

4. Rapiscan do të mbajë dhe të mbështesë vendet dhe operacionet, në mënyrë që të ruajë nivelet e shërbimit të përcaktuara në shtojcën B.

9.2 Bashkëpunimi. Autoriteti pranon ofrimin në kohë dhe në mënyrë të rregullt: a) të menaxhimit të trafikut; b) të ngarkesave; dhe c) të shërbimeve, asistencës, bashkëpunimit dhe informimit me të dhënat e duhura dhe të plota nga nëpunësit e saj, agjentët dhe punëmarrësit është thelbësore për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara dhe se Rapiscan nuk do të jetë përgjegjës për asnjë mangësi në kryerjen e shërbimeve të përcaktuar nëse këto mangësi rezultojnë nga mungesa e dhënies së bashkëpunimit të plotë nga ana e Autoritetit. Bashkëpunimi përfshin, por pa u kufizuar, caktimin e një projektmenaxheri për të komunikuar me Rapiscan gjatë kryerjes së shërbimeve të përcaktuara. Në veçanti, bashkëpunimi nga Autoriteti do të përfshijë, duke përdorur përpjekjet më të mira të ndihmojë Rapiscan që të përftojë të gjitha lejet dhe miratimet e nevojshme sipas legjislacionit të zbatueshëm për ndërtimin dhe instalimin e punimeve civile dhe sistemeve (përfshirë pa kufizim çdo leje apo miratim ndërtimi, për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë apo mjedisit të kërkuara, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e punimeve civile dhe sistemeve në përputhje me propozimin), si dhe lejet apo miratimet e çdo lloji për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara (për shembull, lejet e punës dhe licencat apo lejet e ndotjes radioaktive), në mënyrë të tillë që asnjë prej vendeve të mos i



mungojë ndonjë aprovim qeveritar me qëllim ndërtimin apo bërjen e tyre funksionale. Në rast të vonesës së bashkëpunimit nga Autoriteti, pa paragjykuar ndonjë të drejtë tjetër të ofruar nga ligji apo kjo Marrëveshje, afati kohor për Rapiscan për përmbushjen e çdo detyrimi ende të papërmbushur sipas kësaj Marrëveshjeje do të zgjatet në kohë sipas kohëzgjatjes së kësaj vonese. Për shmangien e çdo dyshimi, Rapiscan do të jetë e vetme përgjegjëse për të aplikuar dhe për t'u siguruar që ajo i ka të gjitha lejet e nevojshme dhe/ose licencat dhe autorizimet siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë herë pas here.

9.3 Personeli. Rapiscan do të sigurojë personelin, i cili do të kryejë shërbimet e përcaktuara. Rapiscan operon si kontraktor i pavarur i Autoritetit dhe jo si një punëmarrës i Autoritetit. Rapiscan ka të drejtën të punësojë kontraktorë të pavarur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara. Personeli nuk duhet të jetë detyrimisht punëmarrës i Rapiscan. Rapiscan, me kostot dhe shpenzimet e veta do të kryejë kontrole mbi kualifikimet, në mënyrë që të përzgjedhë personelin operativ të siguruar nga Rapiscan dhe të përcaktuar si të tillë prej Rapiscan. Në lidhje me personelin e tyre, palët duhet të respektojnë përcaktimet në vijim:

a) Autoriteti do të sigurojë se ka personel të mjaftueshëm, në mënyrë që të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me Rapiscan lidhur me zbatimin nga ana e Rapiscan dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë.

b) Rapiscan do të zëvendësojë menjëherë çdo punonjës, i cili është dënuar nga një vendim gjykatë për kryerjen e një vepre penale ose kundërvajtje në kundërshtim me përshkrimet e detyrave specifike të punës dhe detyrimeve në lidhje me shërbimet e përcaktuara, pasi Rapiscan është vënë në dijeni të vendimit të gjykatës apo kundërvajtjes.

c) Rapiscan do të sigurojë se ka personel të mjaftueshëm, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë.

d) Autoriteti mund të urdhërojë Rapiscan për t'i dhënë fund përfshirjes në ofrimin e shërbimeve të ndonjë prej personelit të Rapiscan për të cilin Autoriteti beson se paraqet një rrezik për sigurinë. Vendimi i Autoritetit do të jetë përfundimtar dhe Autoriteti nuk është i detyruar të japë ndonjë arsye. Pavarësisht nga dispozitat e tjera në këtë Kontratë, në qoftë se urdhri i Autoritetit sipas këtij paragrafi në mënyrë të arsyeshme pritet të ketë një ndikim mbi veprimtarinë e menjëhershme të Rapiscan, atëherë Rapiscan nuk duhet të mbahet përgjegjëse në lidhje me ndryshimet në nivelin e shërbimeve, të cilat vijnë për shkak se vendi/et përkatës/e nuk kanë personelin e mjaftueshëm si pasojë e një urdhri të tillë për një periudhë të arsyeshme kohore pas marrjes së urdhrave të tillë.

e) Rapiscan do të bëjë përpjekjet maksimale për të siguruar vazhdimësinë e personelit dhe për të siguruar që të ardhurat që u ofrohen personelit kyç të saj të angazhuar në ofrimin ose në menaxhimin e shërbimeve të përcaktuara është të paktën po aq i lartë sa standardet e industrisë për një operator koncesionar që operon me praktikë të mirë industriale për shërbime, vende dhe ambiente të ngjashme.

9.4 Ekipi i projektit. Autoriteti me anë të kësaj Kontrate përcakton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë, si përfaqësuesin ekzekutiv të saj, i cili do të trajtojë të gjitha çështjet operative në lidhje me këtë Kontratë. Autoriteti do të caktojë, gjithashtu, një menaxher të projektit, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së Rapiscan lidhur me shërbimet sipas kësaj Kontrate dhe për të vepruar si pika e dytë e kontaktit për Rapiscan në marrëdhënie me Autoritetin. Brenda 30 ditëve nga data efektive, Rapiscan do të punësojë, gjithashtu, një menaxher projekti me kohë të plotë, i cili do të jetë personi përgjegjës që nga data e fillimit të operimeve për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara dhe do të shërbejë si pika e parë e kontaktit për Autoritetin. Palët do të shkëmbejnë emrin dhe kontaktet e menaxherëve përkatës të projektit. Çdo palë mund të ndryshojë menaxherin e saj të projektit, me kusht që pala që do të ndryshojë menaxherin duhet të njoftojë menjëherë me shkrim palën tjetër duke specifikuar menaxherin e ri.

9.5 Fillimi i operimeve. Për çdo vend, veprimtaritë operative fillojnë kur Rapiscan të dorëzojë para Autoritetit një vërtetim me shkrim se pajisjet, personeli i Rapiscan dhe vendi është gati për operim. Rapiscan do të jetë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të skanimeve dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave operative në atë vend, që nga dita e parë kalendarike e muajit që pason datën kur një certifikim i tillë me shkrim është dhënë. Autoriteti do të fillojë pagesat në përputhje me vendin sipas seksionit 10. Me anë të ilustrimit vendi do të funksionojë siç është përcaktuar në shtojcën E.

9.6 Forca madhore. Nëse për shkak të një ngjarjeje të forcës madhore, Rapiscan ndikohet në përmbushjen e çdo detyrimi të kësaj Marrëveshjeje, Rapiscan nuk do të jetë përgjegjëse sipas kësaj Marrëveshjeje ndaj Autoritetit për moskryerjen, ose për mënyrën e kryerjes së këtij detyrimi, deri në masën që, dhe për periudhën e kohës gjatë së cilës Rapiscan ndikohet nga kjo ngjarjeje e forcës madhore. “Ngjarje e forcës madhore” do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë (ose çdo kombinim i ngjarjeve apo i rrethanave), e cila është ose janë përtej kontrollit të palës së prekur pa fajin ose neglizhencën e saj, përfshirë pa kufizim, ngjarjet e mbinatyrshe, motit të keq, fatkeqësive natyrore, luftërave apo agresioneve të tjera, grevat, trazirat civile, aktet shtetërore, urdhra apo rregullore, mospërmbushjet e palëve të treta, mungesa dhe ndërprerje për një kohë të gjatë të energjisë elektrike, që zgjat për më shumë se 20 ditë të vazhdueshme.

9.7 Autoriteti mund ta përfundojë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim, pa penalitete nëse ka shkelje të nenit 5.1 nga ana e Rapiscan për të cilat Autoriteti i kundërshton përveçse nëse: i) Autoriteti ishte vetë në shkelje të nenit 5.1 për shkak të mbajtjes apo të vonesës në mënyrë të paarsyeshme të miratimit të saj; ose ii) Autoriteti ka dhënë pëlqimin e tij paraprak me shkrim për një veprim të tillë. Për qëllime të këtij neni, një vonesë në përgjigje të një kërkesë për miratim për më shumë se 30 ditë, do të konsiderohet të jetë një vonesë e paarsyeshme.

9.7.1 Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, Autoriteti nuk mund ta përfundojë këtë kontratë sipas nenit 9.7 më sipër, përveçse kur:

- a) Autoriteti ka njoftuar Rapiscan për një shkelje të nenit 5.1; dhe
- b) kanë kaluar 45 ditë nga një njoftim i tillë; dhe
- c) Rapiscan vazhdon të jetë në shkelje të nenit 5.1; edhe pasi periudha 45-ditore ka kaluar.

9.7.2 Rapiscan do të njoftojë Autoritetin me shkrim një (1) muaj para çdo ndryshimi të propozuar të Rapiscan.

10. PAGESA

Për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara, Autoriteti do të paguajë Rapiscan si, më poshtë:

10.1 Autoriteti duhet t'i paguajë Rapiscan me baza ditore të gjitha pagesat e tarifës së shërbimit të skanimet për deklaratë që Autoriteti do të ketë mbledhur nga palët e treta në lidhje me shërbimet e përcaktuara, duke zbritur çdo tarifë të aplikuar nga banka në lidhje me një pagesë të tillë të bërë nga Autoriteti për Rapiscan, tarifa këto, të cilat do të përballohen nga Rapiscan. Në fund të çdo muaji, Autoriteti do t'i sigurojë Rapiscan një deklaratë që parashtron numrin e deklaratave doganore dhe llogaritjen e shumës së pagesës bashkekzistuese. Për çdo muaj kalendarik, palët do të ballafaqojnë të dhënat e tyre në lidhje me pagesat e përcaktuara këtu brenda 5 ditëve pune pas përfundimit të muajit përkatës (duke përfshirë çdo muaj të pjesshëm kalendarik). Çdo pagesë mujore e ballafaquar që aplikohet referuar në një muaj të caktuar do të jetë e detyrueshme dhe e pagueshme jo më vonë se 20 ditë pas përfundimit të atij muaji. PAGESA të tilla do të bëhen në monedhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

10.2 Shuma e pagesës mujore do të llogaritet, si më poshtë:

10.2.1 Pasi të pesta vendet kanë filluar operimin, çdo pagesë do të llogaritet si numri total i deklaratave doganore për mallrat që hyjnë dhe dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, përfshirë importet, eksportet dhe transitin ndërkombëtar (ashtu siç përdoret në këtë Marrëveshje, termi “deklaratë” do të thotë çdo deklaratë dhe “deklaratat” do të thotë të gjitha deklaratat për periudhën e përcaktuar), gjatë periudhës përkatëse, shumëzuar me normën deklarative (siç



përcaktohet më poshtë). Për shmangien e dyshimit, numri i deklaratave do të përfshijë të gjitha deklaratat në të gjithë Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe deklaratat e përpunuara në të gjitha pikat doganore. Ky numër nuk do të përfshijë: i) deklaratat, vlera e të cilave është më pak se 1000 euro; ii) deklarata importi 7 me llojin e procedurës 78; dhe iii) deklarata importi 9 (IM 9), që dalin nga magazinat doganore dhe magazinat e lira doganore. Me anë të një shembulli dhe vetëm për qëllime ilustrimi, Autoriteti paraqet se numri i deklaratave për vitin 2012 ka qenë 396,819, megjithatë, kur të aplikohen përjashtimet e përcaktuara në pikën (i), (ii) dhe (iii) më sipër një numër i tillë do të reduktohet në 320,000 deklarata.

10.2.2 Për qëllimet e klauzolës së mësipërme, referenca mbi kategoritë ose llojet e procedurave të deklaratave doganore do të kenë kuptimin që i është dhënë me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13 prill 1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, siç janë në fuqi në datën e kësaj Kontrate.

10.2.3 Për periudhën përpara fillimit të operimit të pesë vendeve sipas seksionit 9.5, pagesa mujore do të jetë shuma e llogaritur sipas seksionit 10.2.1, pjesëtuar me pesë, shumëzuar me numrin e vendeve që Rapiscan ka certifikuar si operativ.

10.3 Tarifa e shërbimit të skanimit do të jetë 39.00 € .TVSH-ja do të aplikohet në masën 0%. Tarifa e shërbimit të skanimit për deklaratë do të paguhet në monedhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë, duke aplikuar të njëjtin kurs këmbimi të monedhës që autoriteti doganor shqiptar aplikon në lidhje me mbledhjen e detyrimeve doganore sipas Kodit Doganor dhe dispozitave zbatuese të tij.

10.4 Nëse pagesat nga ana e Autoritetit janë bërë të pagueshme lidhur me tarifat e shërbimit të skanimit për deklaratë, por nuk janë paguar brenda ditës së 20-të të muajit pasardhës, Rapiscan do të faturojë një tarifë financiare prej 1.5% në muaj, e përlllogaritur për muajt e pjesshëm mbi bazën e një muaji me 30 ditë.

10.5 Autoriteti do të mbajë regjistra në mënyrë të plotë dhe të saktë, ku të përmbahen të gjitha të dhënat e nevojshme që tregojnë shumat e deklaratave doganore dhe pagesat e Rapiscan. Autoriteti duhet t’i japë Rapiscan akses në kohë reale dhe në çdo kohë të databazës së Autoritetit. Rapiscan do të ketë të drejtën, që me shpenzimet e veta të kontrollojë regjistrat dhe databazën e Autoritetit lidhur me deklaratat doganore dhe pagesat me qëllimin e vetëm për të kontrolluar nëse llogaritë janë bërë në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje. Nëse nga auditimi rezulton që Autoriteti i ka paraqitur të dhëna ose informacione të pasakta Rapiscan, ose nuk ka përmbushur detyrimet e pagesave sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti duhet të ndreqë në mënyrë të menjëhershme këtë mospërputhshmëri.

10.6 Rapiscan do t’i paguajë Autoritetit një tarifë koncesionare që llogaritet si 2% e të ardhurave për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara. Kjo tarifë koncesionare do të mbahet nga pagesat që Autoriteti i detyrohet Rapiscan.

11. TË DHËNA

Autoriteti do të zotërojë të gjitha të dhënat, informacionet, imazhet ose të gjitha materialet e tjera të përftuara ose të gjeneruara gjatë ofrimit të shërbimeve të përcaktuara (të dhënat). Këto të dhëna do të përjashtojnë çdo kod software-i të krijuar nga Rapiscan. Rapiscan do të ketë të drejtën e aksesit dhe përdorimit të palimituar të të dhënave sipas përcaktimeve të veta, përfshirë pa kufizim, për qëllime mbi trajnimin dhe zhvillimin e produktit, në pafundësi. Për shmangien e çdo dyshimi, çdo përdorim i tillë i të dhënave nga Rapiscan që është përtej përdorimit normal për qëllimet e shërbimeve të përcaktuara nuk do të shtrihet në të dhënat personale, të tilla si emrat e palëve të treta, duke u bërë subjekt i procedurave të skanimit apo të identifikimit të automjeteve.

12. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

12.1 Përfaqësimet dhe garancitë e Autoritetit. Autoriteti siguron përfaqësimet dhe garancitë, si më poshtë vijon:

12.1.1 Kompetencat. Autoriteti ka kompetencën dhe autoritetin e kërkuar për të lidhur këtë Marrëveshje, si dhe të gjithë dokumentacionin e duhur për të hyrë në këtë Marrëveshje. Të gjitha
3200

veprimet ligjore që duhen kryer nga Autoriteti për të autorizuar nënshkrimin, transferimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje janë përmbushur sipas ligjit dhe në mënyrë efektive. Në datën efektive të kësaj Marrëveshjeje, kjo e fundit do të bëhet një detyrim i vlefshëm, obligues dhe i zbatueshëm mbi Autoritetin.

12.1.2 Përputhshmëria me rregulloret e koncesioneve. Autoriteti është në pajtueshmëri me të gjitha ligjet mbi koncesionet, urdhëresat, rregullat, urdhrat, dekretet dhe rregulloret e zbatueshme për Autoritetin në përputhje me kërkesat dhe prokurimet e shërbimeve të përcaktuara, si dhe nënshkrimin, transferimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

12.1.3 Mungesa e konfliktit. Nënshkrimi, zbatimi dhe transferimi i kësaj Marrëveshjeje nuk rezulton në shkelje të termave dhe kushteve të ose të përbëjë një shmangie nga çdo marrëveshje që Autoriteti kushtëzohet dhe këto veprime nuk do të rezultojnë as në shkelje të ndonjë detyrimi, ligji, urdhërese, rregulloreje, urdhri apo dekreti të zbatueshëm për Autoritetin.

12.1.4 Autoriteti vërteton dhe garanton që ka sisteme të mjaftueshme dhe të përshtatshme, si dhe mjete të tjera për të mbajtur regjistra dhe librat e llogarive me të dhëna të plota dhe të sakta që përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme që tregojnë shumat e deklaratave doganore për të përmbushur kërkesat e paraqitura në seksionin 10 të kësaj Marrëveshjeje.

12.2 Përfaqësimet dhe garancitë e Rapiscan. Rapiscan siguron përfaqësimet dhe garancitë si më poshtë vijon:

12.2.1 Kompetenca. Rapiscan ka kompetencën dhe autoritetin e kërkuar për të lidhur këtë Marrëveshje, si dhe të gjithë dokumentacionin e duhur për të hyrë në këtë Marrëveshje. Të gjitha veprimet korporative apo veprime të tjera, që duhen kryer nga Rapiscan për të autorizuar nënshkrimin, transferimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje janë përmbushur sipas ligjit dhe në mënyrë efektive. Me nënshkrimin dhe transferimin në mënyrë të plotë të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të bëhet një detyrim i vlefshëm, obligues dhe i zbatueshëm mbi Rapiscan.

12.2.2 Mungesa e konfliktit. Nënshkrimi, zbatimi dhe transferimi i kësaj Marrëveshjeje nuk rezulton në shkelje të termave dhe kushteve të ose të përbëjë një shmangie nga çdo marrëveshje që Rapiscan kushtëzohet dhe këto veprime nuk do të rezultojnë as në shkelje të ndonjë detyrimi, ligji, urdhërese, rregulloreje, urdhri apo dekreti të zbatueshëm për Rapiscan.

12.2.3 Rapiscan dhe personeli i angazhuar në ofrimin e shërbimeve kanë aftësitë, mbështetjen teknike dhe kapacitetin e kërkuar për të përmbushur të gjitha detyrimet në përputhje me shërbimet e kërkuara nga kjo Kontratë dhe Rapiscan ka kapacitetin e duhur financiar për të përmbushur plotësisht këtë Kontratë, dhe secili prej nënkontraktorëve të saj, nëse aplikohet, janë gjithashtu kompetentë për të kryer shërbimet e kërkuara në këtë Kontratë. Rapiscan nuk duhet të përdorë me dijeninë e saj shërbimet e asnjë nënkontraktori ose këshilluesi të pakualifikuar me qëllim kryerjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate.

12.2.4 Rapiscan nuk ofron asnjë garanci përveç atyre të dhëna shprehimisht këtu, në mënyrë të shprehur apo të nënkuptuar, bazuar në ndonjë teori ligjore, për ndonjë çështje, përfshirë, por pa u kufizuar në ndonjë garanci që shërbimet do të shfaqin prezencën e materialeve ose elementeve për të cilat janë dizenuar se janë të përshtatshme për çdo qëllim ose nevojë të veçantë se saktësia e skanimeve do të jetë pa asnjë gabim, ose që shërbimet do të jenë të pandërprera.

13. DATA EFEKTIVE E MARRËVESHJES

13.1 Data efektive e kësaj Marrëveshjeje do të jetë data në të cilën do të përmbushen të gjitha kushtet si më poshtë:

13.1.1 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka nxjerrë vendimin për miratimin e kësaj Marrëveshjeje.

13.1.2 Parlamenti i Shqipërisë (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë) ka miratuar këtë Marrëveshje dhe ky miratim do të ketë hyrë në fuqi.



13.1.3 Të gjitha ligjet, rregulloret dhe/ose urdhrat të nxjerra nga Parlamenti i Shqipërisë (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë), Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të konsideruara të nevojshme nga Rapiscan në kërkesat për skanimin e kontejnerëve dhe automjeteve të tjera, duhet të jenë miratuar dhe të jenë në fuqi dhe të kenë efekt.

13.1.4 Parlamenti i Shqipërisë (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë) do të ketë miratuar një ligj ku shërbimet e skanimit doganor përfshirë shërbimet e ofruara nga Rapiscan në këtë Kontratë do të jenë shërbime me TVSH në masën 0%.

13.1.5 Të gjitha ligjet, rregulloret dhe/ose urdhrat përkatës do të jenë miratuar, në mënyrë që të përjashtojë nga TVSH-ja Rapiscan në importin e pajisjeve të nevojshme për zbatimin e projektit të tij sipas kësaj Kontrate.

13.2 Autoriteti do të bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar se kushtet e parashikuara në seksionin 13.1.1, 13.1.2 dhe 13.1.3 të jenë përmbushur sa më shpejt të jetë e mundur.

14. KONFIDENCIALITETI

14.1 Mosdeklarimi. Përpara, gjatë ose pas kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje palët mund t'i japin njëra-tjetrës informacione konfidenciale. Pala që merr informacionin konfidencial referohet në vijim si "përfituesi" dhe pala që jep informacionin konfidencial referohet si "dhënësi". Përfituesi duhet të mbajë informacionin konfidencial në mënyrë tërësisht konfidenciale, nuk duhet ta deklarojë atë tek asnjë palë e tretë dhe do të ruajë të gjithë informacionin konfidencial me jo më pak se të njëjtën shkallë të kujdesit që përfituesi përdor zakonisht për ruajtjen e informacionit të vet konfidencial, por të paktën me një kujdes të arsyeshëm. Përfituesi do të përdorë informacionin konfidencial me qëllimin e vetëm për vlerësimin dhe/ose përmbushjen e detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Marrëveshjeje.

14.2 Deklarimi i lejuar. Ndalimi në dhënien e informacionit konfidencial i përcaktuar në këtë Marrëveshje nuk do të zbatohet për: a) informacionin konfidencial, i cili ishte i njohur nga përfituesi në kohën kur përfituesi kishte marrë këtë informacion konfidencial nga dhënësi, për sa kohë që marrja për herë të parë nga përfituesi të informacionit konfidencial provohet nga dokumentet në posedim të përfituesit; b) informacioni konfidencial i dhënë për përfituesin nga palët e treta me të drejtë ligjore për të dhënë këtë informacion konfidencial; c) informacioni konfidencial në dispozicion të publikut në kohën kur përfituesi merr informacionin konfidencial, ose që në vijim u vu në dispozicion të publikut në mënyrë të ligjshme dhe jo në shkelje të kësaj Marrëveshjeje; d) informacioni konfidencial që përfituesit iu kërkua që të deklaronte në përputhje me veprimet apo urdhrat gjyqësorë që kanë juridiksion mbi përfituesin, ose në përputhje me çdo kërkesë të çdo agjencie ose autoriteti shtetëror që kanë juridiksion mbi përfituesin, por vetëm për aq kohë sa, para dhënies së informacionit, përfituesi i jep dhënësit njoftim me shkrim për informacionin e dhënë dhe i jep dhënësit mundësinë e kundërshtimit të kësaj kërkesë. Më tej, njihet dhe pranohet se Rapiscan është degë e shoqërisë mëmë, që është një shoqëri e listuar në bursë, dhe si e tillë, hyrja në këtë Marrëveshje mund të kërkojë që shoqëria mëmë të publikojë këtë Marrëveshje me njoftim elektronik dhe ky publikim nuk duhet të jetë në shkelje të kësaj Marrëveshjeje.

14.3 Rapiscan duhet të operojë në përputhshmëri me legjislacionin shqiptar të aplikueshëm të mbrojtjes së të dhënave që mund të jenë në fuqi herë pas here.

15. PRONËSIA INTELEKTUALE

Asgjë që përmbahet në këtë Marrëveshje, në mënyrë të shprehur, nënkuptuar ose ndryshe, nuk do të krijojë për asnjë palë ndonjë të drejtë, titull, interes ose licencë për shpikjet, patentat, markat tregtare, emrat tregtarë, të drejtat e autorit, software ose dokumentacione software ose çdo të drejtë tjetër të pronësisë intelektuale të palës tjetër gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate. Me mbarimin e kësaj Kontrate, Palët bien dakord se të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të përfituara nga ana e Rapiscan gjatë kohës dhe kryerjes së shërbimeve të përcaktuara sipas kësaj Kontrate, do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues. Pavarësisht nga sa më sipër, të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të lidhura me pajisjet janë dhe do të mbeten në pronësi ekskluzive të Rapiscan.

16. DËMSHPËRBLIMI

16.1 Rapiscan, për llogari të vet dhe të nënkontraktuesve të saj, do të mbrojë, do të kompensojë dhe do të mbajë të padëmtuar interesat e Autoritetit, nëpunësve të tij, drejtorëve, përfaqësuesve, zyrtarëve, agjentëve dhe punëmarrësve të emëruar (secili “i kompensuari i Autoritetit” dhe së bashku “të kompensuarit e Autoritetit”) në lidhje me kryerjen e shërbimeve, nga dhe ndaj çdo humbjeje dhe shpenzimi lidhur me:

16.1.1 Neglizhencën e Rapiscan ose nënkontraktuesve të saj, mashtrimin, ose mosveprimi me dashje, përfshirë, por jo vetëm, dëmtimet, vdekjet ose dëmet të çdo personi ose pasurie, në masën që kjo neglizhencë, mosveprim me dashje ose mashtrim janë përcaktuar me vendim përfundimtar ose urdhër i formës së prerë të një gjykate që ka juridiksionin e duhur;

16.1.2 Dëmtimet ose vdekjet e punëmarrësve të Rapiscan ose të çdo nënkontraktori sipas çdo ligji për kompensimin e punëmarrësve;

16.1.3 Çdo shkelje të pronësisë intelektuale (përfshirë çdo patentë, markë tregtare ose të drejte autori) nga Rapiscan ose nënkontraktorët;

16.1.4 Mospërbushjen e detyrimeve nga Rapiscan ndaj çdo nënkontraktori;

16.1.5 Çdo përgjegjësi e punëdhënësit ose e punëmarrësve të Rapiscan ose nënkontraktorëve të saj.

16.2 Detyrimet e Rapiscan sipas këtij seksioni për të dëmshpërblyer dhe mbajtur të pacenuar interesin e çdo dhe të gjithë të kompensuarve të Autoritetit nga dhe ndaj çdo humbjeje dhe shpenzimi përjashton: a) pjesën e humbjeve dhe shpenzimit të shkaktuar nga neglizhenca ose veprimi të gabuar me dashje, gabimi ose mosveprimi nga ana e të kompensuarve të Autoritetit; b) rastet për të cilat Autoriteti dëmshpërblen Rapiscan; dhe c) rastet, të cilat nuk janë nën kontroll të Rapiscan.

16.3 Në diskrecionin e të kompensuarve të Autoritetit, Rapiscan duhet të mbrojë paditë e ngritura ndaj çdo humbjeje dhe shpenzimi dhe duhet të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet e arsyeshme e karakteristike për to, por të kompensuarit e Autoritetit kanë të drejtën, me zgjedhjen dhe shpenzimet e tyre, për të marrë pjesë në mbrojtjen kundër çdo padie, pa çliruar Rapiscan nga asnjë detyrim që rrjedh nga kjo Kontratë. Çdo marrëveshje jashtëgjyqësore duhet të bëhet vetëm me miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit ose të kompensuarve të Autoritetit, sipas rastit, nëse kjo marrëveshje jashtëgjyqësore kërkon ndonjë veprim nga ana e Autoritetit ose të kompensuarve të Autoritetit.

16.4 Miratimi nga Autoriteti i çdo nënkontraktori, sipas rastit, nuk do të çlirojë Rapiscan nga asnjë detyrim, përgjegjësi ose detyrë. Rapiscan do të jetë e vetme përgjegjëse ndaj Autoritetit për veprimet ose mosveprimet e nënkontraktorëve dhe çdo nënkontraktori, nëpunësi, punëmarrësi dhe agjenti, secili prej të cilëve do të, për këtë qëllim, konsiderohen si agjentë ose punëmarrës Rapiscan si rrjedhojë e nënkontraktimit.

16.5 Autoriteti do të dëmshpërblejë dhe do të mbajë të pacenuar interesin e Rapiscan, nëpunësve të saj, drejtorëve, ortakeve, punëmarrësve dhe agjentëve, si dhe pasardhësit e tyre dhe cakton, kundër shkaktimit të çdo humbjeje, përgjegjësie, dëmi ose shpenzimi të çdo natyre, ose të përllogaritur, të plotë, të kushtëzuar ose ndryshe, përfshirë pa kufizime, tarifat e avokatëve dhe kostot (edhe nëse padia është ngritur ose jo), në lidhje me, por pa u kufizuar në: a) çdo pretendim i ngritur ose i lidhur me shkeljet e Autoritetit ndaj përfaqësimeve, garancive ose miratimeve të kësaj Marrëveshjeje; b) çdo pretendim për dëmtim të çdo personi, punëmarrësi, dhe/ose dëmi të pasurisë, përfshirë pronën e Rapiscan, në masën që dëmtimi ose dëmi të ketë ardhur nga neglizhenca, mashtrimi ose mosveprimi me dashje nga ana e Autoritetit, në masën që kjo neglizhencë, ose mosveprimi me dashje ose mashtrim janë përcaktuar me vendim përfundimtar dhe urdhër të formës së prerë të një gjykate që ka juridiksionin e duhur.

16.6 Pavarësisht nga sa më sipër, Rapiscan nuk do të dëmshpërblejë të kompensuarit e Autoritetit për humbjet dhe shpenzimet e shkaktuara nga forca madhore.



16.7 Autoriteti heq dorë nga e drejta e tij dhe në mënyrë të parevokueshme liron punëmarrësit, nëpunësit, drejtorët, anëtarët, ortakët, përfaqësuesit, agjentët, avokatët, filialet, degët, shoqërinë mëmë, pasardhësit e Rapiscan (palët e liruara) nga çdo pretendim që mund të ketë tani ose në të ardhmen ndaj palëve të liruara për çdo kosto, humbje, përgjegjësi, dëm apo shpenzim të shkaktuar apo të fshehur, që rezultojnë nga pajisjet, përveç specifikimeve të performancës operuese dhe/ose atribuar materialit të zbuluar ose të pazbuluar; ose që rrjedh nga një vepër penale, akt terrorist ose luftë, kryer nga një palë e tretë. Rapiscan nuk duhet të dëmshpërblejë Autoritetin për këtë lirim ose heqje dore. Palët bien dakord të zbatojnë çlirime të tjera nga detyrimet, në formë dhe në përmbajtje siç mund të konsiderohen të kënaqshme për to.

17. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSIVE

17.1 Përgjegjësitë totale. Deri në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm, përgjegjësitë totale të secilës palë përkundrejt palës tjetër për dëmet që rrjedhin ose në lidhje me këtë Marrëveshje, pavarësisht nga forma e veprimit që shkakton këtë përgjegjësi (sipas çdo teorie, qoftë kjo kontraktore, jashtëkontraktore, ligjore ose formë tjetër) nuk do të kalojë shumën totale të pagesës së bërë nga Autoriteti për Rapiscan gjatë vitit të parë kalendarik të operimit vjetor të plotë pas datës së fillimit të operimeve e të gjitha vendeve. Kufizimi i përgjegjësisë nuk do të zbatohet për: a) detyrimet e dëmshpërblimit të Autoritetit sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshjeje; dhe b) tarifat e përfundimit të përcaktuara në seksionin 18.2.3.

17.2 Kufizime në dëme të tjera. Në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm dhe pavarësisht nga përcaktimet e kësaj Marrëveshjeje, në kundërshtim, përjashtuar përcaktimet e bëra në shtojcën B, ose mospërmbushje të çdo qëllimi thelbësor të kufizimit të përgjegjësisë, asnjëra nga palët nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dëm indirekt, të posaçëm, të prejardhur apo të rastësishëm të çdo lloji, ose për çdo dëm që rezulton nga humbjet ose ndërprerjet e veprimtarisë tregtare, grevave, humbje të të dhënave ose mosrealizim i fitimeve, që rrjedhin nga ose lidhen me këtë Marrëveshje ose objektin e saj, megjithatë e shkaktuar, edhe pse pala jo në shkelje është këshilluar ose duhet të kishte qenë në dijeni për mundësinë e ardhjes së këtyre dëmeve.

18. PËRFUNDIMI

18.1 Mospërmbushja e detyrimeve. Palët do të jenë në shkelje, nëse:

18.1.1 Pala bën shkelje thelbësore të garancive, miratimeve ose përfaqësimeve të kësaj Marrëveshjeje, nëse përfaqësimi ose garancitë janë ose bëhen të rreme në mënyrë thelbësore, dhe nëse këto shkelje ose të pavërteta nuk ndreqen brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga dita e njoftimit, ose nëse këto shkelje nuk mund të ndreqen brenda dyzet e pesë (45) ditëve.

18.1.2 Pala është subjekt i procedurave për palën që do të vlerësohet si vullnetarisht e falimentuar, miraton paraqitjen e procedurave të falimentimit, dorëzon ankimin ose përgjigjet ose jep pëlqimin për riorganizimin sipas ligjit për falimentin, jep miratimin për dorëzimin e ankimit ose të caktimit të një kujdestari, likuidatori, të besuari ose të caktuari të lidhur me këtë palë ose me çdo pjesë thelbësore të aseteve, pasurive, bën një transferim në dobi të kreditorëve ose kryen çdo veprim tjetër në vazhdimësi të të mësipërmeve.

18.2 Të drejtat e përfundimit

18.2.1 Zgjidhja për mospërmbushje. Në rast të çdo mospërmbushje, pala që nuk është në shkelje mund të zgjidhë këtë Marrëveshje në mënyrë të menjëhershme me njoftim me shkrim.

18.2.2 Zgjidhja për përshtatshmëri nga Autoriteti. Autoriteti ka të drejtën të zgjidhë këtë Marrëveshje për përshtatshmërinë e saj në çdo kohë pas datës së ekzekutimit me një njoftim paraprak me shkrim nëntëdhjetë (90) ditë para drejtuar Rapiscan dhe pagesën e plotë të tarifës për zgjidhjen e parakohshme (siç përcaktohet në seksionin 18.2.3) brenda kësaj periudhe:

18.2.3 Tarifa për zgjidhjen e parakohshme. Nëse Autoriteti zgjidh këtë Marrëveshje për përshtatshmërinë e saj në përputhje me seksionin 18.2.2, do të zbatohen tarifat si më poshtë, si dëme të përlllogaritura paraprakisht dhe jo si penalitete:

a) Nëse zgjidhja do të bëhet në një datë kur në mungesë të zgjidhjes do të kishin mbetur shtatë vjet ose më shumë nga zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë çdo zgjatje të kohëzgjatjes, sipas rastit), Autoriteti do të paguajë për Rapiscan një tarifë zgjidhjeje në shumën e barabartë me pagesat mujore mesatare totale që Autoriteti paguan për Rapiscan në vitin kalendarik para datës së përfundimit (tarifat mesatare) shumëzuar me shtatëdhjetë e dy (72) muaj;

b) Nëse zgjidhja do të bëhet në një datë kur në mungesë të zgjidhjes do të kishin mbetur më shumë se katër vjet, por më pak se shtatë nga zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë çdo zgjatje të kohëzgjatjes, sipas rastit), Autoriteti do të paguajë për Rapiscan një tarifë zgjidhjeje në shumën e barabartë me tarifat mesatare shumëzuar me tridhjetë e gjashtë (36) muaj;

c) Nëse zgjidhja do të bëhet në një datë kur në mungesë të zgjidhjes do të kishin mbetur më pak se katër vjet nga zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë çdo zgjatje të kohëzgjatjes, sipas rastit), Autoriteti do të paguajë për Rapiscan një tarifë zgjidhjeje në shumën e barabartë me tarifat mesatare shumëzuar më pak se: i) njëzet e katër (24) muaj; dhe ii) numrin e muajve që do të kishin mbetur nga kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje në mungesë të përfundimit;

d) Për shmangien e çdo dyshimi, nëse Autoriteti zgjidh këtë Marrëveshje për shkak të: i) çdo pamundësie në sigurimin e fondeve të duhura për të mbështetur Autoritetin për përmbushjen e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje; ose ii) çdo akti shtetëror, legjislativ, rregullor ose urdhri, atëherë çdo zgjidhje e tillë e Marrëveshjes do të konsiderohet si zgjidhje për përshtatshmëri të Autoritetit dhe ky i fundit do të paguajë për Rapiscan tarifën e zgjidhjes së parakohshme të llogaritur në mënyrën e caktuar. Për qëllimin e seksionit 18, para mbarimit të vitit të parë, ku pesë vendet janë operuese, në vend të tarifave mesatare, shifra prej 1,462,000.00 € do të përdoret në llogaritë e përcaktuara në pikat “a”, “b” dhe “c” më sipër.

18.3 Heqja dorë nga çdo shkelje apo mospërmbushje të detyrimeve sipas kësaj Kontrate, nuk do të konsiderohet si heqje dore të çdo shkeljeje apo mospërmbushjeje të detyrimeve pasuese. Më tej, heqja dorë nga çdo shkelje apo mospërmbushje të detyrimeve, nuk do të përbëjë një modifikim të termave dhe kushteve të kësaj Kontrate, përveçse nëse është bërë me shkrim sipas përcaktimeve të seksionit 2.

19. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

19.1 Garancia e Rapiscan

19.1.1 Paralel me lidhjen e kësaj Kontrate, Rapiscan duhet t'i paraqesë Autoritetit dokumentin e sigurimit të Kontratës (sigurimi i Kontratës) sipas formës dhe përmbajtjes të specifikuar në RFP.

19.1.2 Autoriteti do t'i kthejë Rapiscan sigurimin e Kontratës (me kusht që sigurimi i Kontratës nuk është paguar) jo më vonë se 30 ditë pas kohëzgjatjes ose zgjidhjes së parakohshme nga Autoriteti sipas seksionit 18.2.2 ose nga Rapiscan sipas seksionit 18.2.1.

20. PUNIMET “JASHTË OBJEKTIT” DHE NDRYSHIMET NË LIGJ

Palët pranojnë dhe bien dakord se nëse do të këtë një ndryshim të ligjit të zbatueshëm, ose në kërkesën e Autoritetit për shërbime shtesë, ose një shtim të shërbimeve të përcaktuara, ose dorëzimin e programuar, palët do të rinegociojnë termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje përfshirë tarifat, pagesat dhe çdo kusht tjetër të nevojshëm për përmbushjen në mënyrën e duhur të shërbimeve të përcaktuara nga ana e Rapiscan, siç mund të ndikohet nga ndryshimet në ligj ose nga kërkesa e Autoritetit.

Pavarësisht çdo përcaktimi ndryshe të përfshirë në këtë Marrëveshje, Autoriteti do të konsiderohet të jetë në shkelje dhe rrjedhimisht të dëmshpërblejë Rapiscan për të gjitha humbjet dhe shpenzimet, nëse ligjet shqiptare apo rregulloret e miratuara bien në kundërshtim me kushtet e Marrëveshjes që nga data e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, ose kanë një efekt material në themelimin, ofrimin e shërbimeve të përcaktuara, dhe/ose shoqëria dhe/ose Rapiscan dhe/ose aftësinë e shoqërisë dhe/ose Rapiscan për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe ose diskriminuese për Rapiscan dhe/ose shërbimet e përcaktuara, duke përfshirë, por pa u



kufizuar, taksat, tatimet ose detyrime të tjera të vendosura vetëm mbi Rapiscan dhe/ose shërbimet e përcaktuara.

21. TË NDRYSHME

21.1 Ndryshimet dhe modifikimet. Asnjë ndryshim apo modifikim i kësaj Marrëveshjeje përfshirë çdo shtojcë të saj nuk do të jetë i vlefshëm, përveçse nëse është bërë me shkrim dhe nënshkruar nga të dyja palët.

21.2 Efekti detyrues. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi në dobi të, dhe do të jenë detyruese për palët dhe përfituesit nga transferimi i të drejtave, zëvendësuesit, administratorët dhe pasardhësve.

21.3 Gjuha e dyfishtë. Kjo Marrëveshje është negociuar në gjuhët shqipe dhe angleze, dhe të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të interpretohen në lidhje me të dyja gjuhët (shqipe dhe angleze), megjithatë, në rast të konfliktit apo mospërputhjes mes versioneve të të dyja gjuhëve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze. Vetëm nëse është rënë dakord ndryshe, gjuha e korrespondencës mes palëve gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje do të jetë gjuha shqipe.

21.4 Monedha. Të gjitha të dhënat monetare të përcaktuara në këtë Marrëveshje janë shprehur në euro.

21.5 Titujt përshkrues. Titujt përshkrues të kësaj Marrëveshjeje, që paraprijnë tekstin e seksioneve të kësaj Kontrate dhe çdo tabelë apo shënim që paraqitet në të, nëse ka, janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate dhe as nuk kontrollojnë, ndikojnë në kuptimin apo interpretimin, apo të kenë ndonjë efekt mbi këtë Kontratë.

21.6 Mjetet juridike të barabarta. Palët bien dakord që dëmshpërblimet monetare të vetme nuk do të jenë zgjidhje e përshtatshme për shkeljet e kësaj Marrëveshjeje dhe, përkatësisht, pa asnjë paragjykim kundrejt ndonjëres apo të gjitha të drejtave dhe mjeteve të tjera që secila prej palëve mund të ketë kundrejt tjetrës, secila prej tyre pa pasur barrën e provës ka të drejtën që të kërkojë mjetet juridike të drejta si ndalimin për kryerjen e një veprimi, kryerjen e një veprimi të posaçëm dhe çdo lehtësim tjetër të drejtë për çdo shkelje aktuale ose të mundshme të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

21.7 Dokumente shtesë. Secila prej palëve duhet të nënshkruajë dhe të dorëzojë të gjitha instrumentet, dokumentet dhe letrat shtesë, dhe duhet të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për t'i dhënë fuqi dhe efekt të plotë të gjitha termave dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

21.8 Interpretimi. Asnjë paqartësi apo dykuptimshmëri e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet ose vendosen në dëm të asnjërës palë, qoftë kjo në përputhje me rregullat e përcaktuara për interpretimin e kontratave apo me rregulla të tjera. Në të kundërt, kjo Marrëveshje është negociuar nga të gjitha palët dhe do të interpretohet sipas kuptimit të zakonshëm të fjalëve të përdorura për të përmbushur në mënyrë të drejtë qëllimet dhe synimet e palëve.

21.9 Kufizimet në dorëheqje. Asnjë heqje dore nga palët ndaj termave apo kushteve të kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si heqje dore nga këta terma dhe kushte në të ardhmen, apo të çfarëdolloj shkeljeje të mëparshme ose të mëvonshme të këtyre termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje apo të çdo marrëveshjeje tjetër, dhe asnjë prej këtyre dorëheqjeve do të jetë detyruese përveçse nëse bëhet me shkrim. Të gjitha mjetet juridike, të drejtat, marrjet përsipër, detyrimet, marrëveshjet e përfshira në këtë Marrëveshje do të jenë të përbashkëta, dhe asnjëra prej tyre nuk do të kufizojë ndonjë mjet juridik, të drejteje, marrjeje përsipër, detyrimi ose marrëveshjeje tjetër të çdo pale të kësaj Marrëveshjeje.

21.10 Transferimi dhe nënlicencimi. Si një term thelbësor i kësaj Kontrate, Rapiscan ka të drejtë të transferojë dhe të kalojë të gjitha ose pjesë të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje të çdo dege të Rapiscan, ose të çdo shoqërie mëmë e Rapiscan, apo të çdo dege të shoqërisë mëmë të Rapiscan, me kusht që Rapiscan të njoftojë Autoritetin dhe të garantojë që shoqëria mëmë ose dega e zotëruar plotësisht prej saj ose dega e shoqërisë mëmë plotëson dhe përmbush të gjitha kërkesat e përmbajtura në këtë Kontratë. Njoftimi për shpërndarjen ose

nënlicencimin duhet t'i njoftohet Autoritetit të paktën 30 ditë para datës efektive të këtij veprimi.

21.11 Nënkontraktimin. Rapiscan nuk mund të nënkontraktojë pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit (aprovimi i së cilit nuk duhet të refuzohet pa arsye) dhe nuk mund të nënkontraktojë më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Rapiscan duhet ta njoftojë Autoritetin për elementet e kontratës së nënkontraktimit dhe duhet të sigurojnë dokumentacionin që provon aftësitë e nënkontraktorëve. Autoriteti duhet të informojë Rapiscan për vendimin e saj brenda 10 ditëve nga marrja e informacionit, duke deklaruar arsyet e miratimit ose të refuzimit.

21.12 Mungesa e partneritetit ose e sipërmarrjes së përbashkët. Kjo Marrëveshje nuk krijon asnjë partneritet apo sipërmarrje të përbashkët midis palëve dhe nuk do të interpretohet sikur mundëson një gjë të tillë. Kjo Marrëveshje nuk krijon asnjë të drejtë që të kushtëzojë palën tjetër.

21.13 Asnjë palë e tretë përfituese. Asnjë person tjetër përveçse palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe pasardhësve apo zëvendësuesve të tyre të lejuar nuk do të kenë asnjë përfitim nga kjo Marrëveshje.

21.14 Të gjitha njoftimet, deklaratat e dokumentet e tjera që palëve u kërkohen ose dëshirojnë që t'i japin palës tjetër duhen të jepen me shkrim në anglisht dhe duhet të dorëzohen personalisht, me postë ekspres, me postë të certifikuar me dorëzim të menjëhershëm, me faks në adresën e përcaktuar si më poshtë të caktuara me shkrim nga palët.

21.15 Njoftimet:

Nëse do t'i dërgohet Autoritetit:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Drejtori i Përgjithshëm

Rruga e Durrësit, Laprakë, Tiranë, Shqipëri

Fax nr. + 355 4 2243914

Nëse do t'i dërgohet Rapiscan:

Jonathan Fleming

Rapiscan Systems, INC.

1901 S. Bell Street, Suite 325

Arlington, Virginia 22202, USA

Fax No. 1-703-812-0335

Me një kopje për:

Victor Sze

Departamenti Ligjor

12525 Chadron Ave.

Hawthorne, CA 90250

Facsimile: 310-970-0862

Dorëzimi do të konsiderohet si përfundimisht i kryer: i) në kohën e shërbimit, nëse dorëzohet personalisht; ii) pesë ditë pas lënies në postë, në adresën e duhur dhe me postë të parapaguar, nëse dërgohet me postë ose postë të certifikuar; iii) me konfirmimin e dorëzimit nga korrieri i postës ekspres; dhe iv) në momentin e dërgimit me postë elektronike (e konfirmimit me shkrim), me kusht që një kopje është postuar me postë brenda 24 orëve nga dërgimi me postë elektronike.

21.16 Ligji mbizotërues dhe vendi i zhvillimit të gjyqit. Kjo Marrëveshje do të qeveriset nga ligji në fuqi në Republikën e Shqipërisë pa marrë parasysh dispozitat ligjore për konfliktet lidhur me këtë Marrëveshje. Çdo lloj mosmarrëveshje që rrjedh ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të ketë të drejtë për t'iu drejtuar arbitrazhit ndërkombëtar, me kusht që pala tjetër duhet të pajiset me njoftim me shkrim lidhur me këtë çështje. Nëse ndonjë Palë i drejtohet për zgjidhje të mosmarrëveshjes Arbitrazhit ndërkombëtar do të zbatohen procedurat si vijon: Numri i arbitrave do të jetë tre (3). Arbitrat do të caktohen në përputhje me rregullat e arbitrazhit ndërkombëtar. Vendi i



arbitrazhit do të jetë Vienna, Austria. Gjuha e përdorur në arbitrazh do të jetë anglishtja. Kostot e arbitrazhit do të përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit. Bazuar në aplikimin e procedurës së arbitrazhit, Palët heqin dorë në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar nga e drejta e tyre për çdo formë ankimi, rishikimi ose rekursi në gjykatën e çdo shteti ose autoriteti gjyqësor, me kusht që kjo dorëheqje duhet bërë në formën e duhur. Zbatimi i juridiksionit të lejuar do të përcaktohet nga Republika e Shqipërisë.

21.17 Heqje dorë nga imuniteti. Në masën që është e mundur nga ana e Autoritetit, në çdo juridiksion në të cilin do të zhvillohen procedurat e gjykimit dhe që mund të vlerësohen në çdo kohë për përcaktimin e çdo pyetje që lind lidhur me ose për zbatimin e kësaj Kontrate (duke përfshirë çdo procedurë interlokutore ose ekzekutimin e ndonjë vendimi që lind prej saj) për të kërkuar të drejtën, ose përndryshe t'i akordohet vetë Autoritetit ose pronës, pasurive ose të ardhurave të tij, imunitet nga paditë apo ndalimet (qoftë në ndihmë të ekzekutimit, para gjykimit ose ndryshe, nëse në bazë të sovranitetit ose ndryshe), gjykimi apo proces tjetër ligjor, në atë masë që në çdo juridiksion të tillë mund t'i atribuohet Autoritetit, apo pronës, pasurive apo të ardhurave (nëse janë apo jo të pretenduara), Autoriteti, nëpërmjet kësaj Kontrate, në mënyrë të parevokueshme, bie dakord të mos kërkojë këtë të drejtë dhe heq dorë nga një imunitet i tillë në masën e plotë të lejuar nga ligji i një juridiksioni të tillë, përveçse kur Autoriteti do të ketë të drejtë të kërkojë imunitet nga paditë, sa i përket zbatimit të vendimeve të arbitrazhit, në lidhje me:

i) “ambientet e misionit” të pranishme apo të ardhshme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të nënshkruara në vitin 1961, “ambientet konsullore” të tashmen ose të ardhmen siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore nënshkruar më 1963-in ose të përdoren ndryshe nga një diplomat apo një mision diplomatik shqiptar ose çdo agjenci apo instrument i tyre;

ii) çdo pronë e paluajtshme, e cila u nënshtrohet përcaktimeve të nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shuma të destinuar për përmbushjen e obligimeve të Republikës së Shqipërisë nën traktatet, konventat ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjet e nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

21.18 Veçueshmëria. Çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje që vlerësohet nga një gjykatë ose juridiksion kompetent të jetë nul, e pavlefshme ose e pazbatueshme do të kufizohen vetëm në masën e nevojshme për ta bërë këtë dispozitë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe ky kufizim nuk do të ndikojë vlefshmërinë ose zbatimin e çdo dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje.

21.19 Ekzistenca. Dispozitat e seksionit 11, 12, 14, 17, 18 dhe 21 të kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas mbarimit të afatit të kësaj Kontrate ose zgjidhjes së parakohshme.

21.20 Bashkëpunimi. Palët pranojnë që bashkëpunimi i tyre i përbashkët është kritik për mundësimin e Rapiscan për të kryer detyrat në mënyrë të suksesshme dhe të efektshme. Çdo palë bie dakord të bashkëpunojë me palën tjetër plotësisht për arritjen e qëllimeve dhe objektivave që janë objekt i kësaj Kontrate, që është në interesin më të mirë të Autoritetit. Autoriteti do të përdorë përpjekjet maksimale dhe do të asistojë Rapiscan në çdo kërkesë të arsyeshme të saj në çdo proces shtetëror në lidhje me shërbimet e përcaktuara në këtë Kontratë, përfshirë, por jo vetëm të gjitha përjashtimet që mund të jepen nga Autoriteti në bazë të ligjit të zbatueshëm për pajisjet që do të përdoren për të ofruar shërbimet e përcaktuara.

21.21 Përmbushja e kërkesave kontraktore. Autoriteti vërteton dhe siguron se ka përmbushur të gjitha procedurat e nevojshme për të kontraktuar Rapiscan. Autoriteti siguron me kuptueshmërinë e saj më të mirë, se nuk ka asnjë ligj ekzistues, rregullore ose rregull që i shtrin efektet mbi Autoritetin, i cili ndalon këtë të fundit për të kontraktuar Rapiscan për shërbimet e kësaj Marrëveshjeje.

21.22 Mangësitë. Nëse Autoriteti ose Rapiscan zbulon ndonjë mangësi thelbësore në dispozitat e Kontratës që vlerësohet të jetë kryesore në zbatimin e suksesshëm të kësaj Kontrate secila prej tyre duhet të informojë palën tjetër me shkrim. Autoriteti dhe Rapiscan do të negociojnë menjëherë në mirëbesim në lidhje me këto çështje, me qëllim që të bëjnë ato rregullime të nevojshme me qëllim përmbushjen e objektivave të Kontratës.

21.23 Titujt, jokontrolli. Titujt e kësaj Kontrate janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të kenë asnjë efekt detyrues dhe as nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate.

21.24 Kopje të ndryshme. Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në një ose me shumë kopje të ndryshme, ku secila prej tyre do të konsiderohet si një dhe i njëjti dokument, dhe do të bëhet e vlefshme kur një ose më shumë prej këtyre kopjeve të ndryshme është nënshkruar nga secila palë dhe i është dërguar palës tjetër.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje që nga data e përcaktuar më sipër.


Rapiscan Systems, INC.
JONATHAN FLEMING
Zëvendës-president

Autoriteti Kontraktues
RIDVAN BODE
Ministër

ANEKSI A SPECIFIKIMET E KRYERJES SË OPERIMEVE

Pajisjet
RAPISCAN G60
RAPISCAN M60
1. Rapiscan Eagle M60

Numri i njësive
tre (3)
dy (2)



1.1 Përmbledhje

Rapiscan Eagle M60 “Eagle M60” është anëtar i Rapiscan M-series për sistemin e lëvizshëm të kontejnerëve dhe automjeteve të afta për të lëvizur në rrugë publike. Eagle M60 është dizenuar për të skanuar kamionë dhe kontejnerë për të verifikuar përmbajtjen, si dhe për të identifikuar prezencën e kontrabandës së fshehur të tilla si armë, eksploziv dhe lëndë narkotike. Njësia përmban pajisjen dhe karakteristikat e kërkuara për kryerjen e inspektimit në vende të tilla si porte detare, kalimin e pikave kufitare dhe postbloqeve në rrugë.

Eagle M60 ka një sistem 6 MV rrezatimi X me një detektor në formën e shkronjës L. Për transportin dedektorit është i vendosur brenda dhe për skanimin montohet në mënyrë të tillë që të krijojë tunelin e inspektimit. Eagle M60 skanon nga kalimi i një apo më shumë objekteve bosh të palëvizshme në drejtim të kundërt ose përpara.



Eagle M60 prodhon një imazh me cilësi të lartë të një automjeti ose kontejneri dhe përmbajtjes së saj, e cila shfaqet menjëherë në monitorim për analizimin e imazhit. Analiza e imazhit kryhet duke përdorur tiparet e plota të softwer-it të inspektuesit të kontejnerëve të Rapiscan (Rapiscan Cargo Viewer).



Figura 1. Eagle M60 – konfigurimi ne vend




Figura 2. Eagle M60 – Konfigurimi ne pozicion (i instaluar)




Figura 3. Eagle M60 – Sistemi imazhit me rreze X

1.2 Sistemi i imazhit

Gjeneratori me rreze X. Eagle M60 përdor një përshpejtues linear për të gjeneruar një rreze 6MV. Gjeneratori me rreze X mbrohet plotësisht dhe rrezet paralele të grumbulluara në formën e një erashke, e cila minimizon dozën radioaktivitetin duke rritur ndërkohë intensitetin e rrezeve në qendrën e objektit që do të skanohet. Forma e erashkës, (figura 3) orientohet në mënyrë të tillë që të inspektojë nga boshti në krye të një kamioni apo kontejneri pa qoshe të prera.

Sistemi i dedektorit. Sistemi i dedektorit të Eagle M60 përdor kristale të shkëlqyeshme të montuara në një diodë që transmeton rreze X. Dedektorët dhe sistemi elektronik organizohen në module në formën e shkronjës L. Ky dizajn mundëson minimizimin e distancës nga gjeneratori tek dedektori të rrezeve X ndërsa ende garanton inspektimin në 100% të një kamioni apo kontejneri. Mburja e dedektorit mbron dedektorin nga përkeqësimi i kushteve mjedisore. Dyert mundësojnë akses të lehtë për modulet individuale të shërbimit. Produkti nga dedektorit dërgohet në sistemin elektronik të imazheve të Rapiscan dhe më pas të postacioni për analizën e imazheve për ekspozim.

Njësia qendrore e kompjuterit. Sistemi kompjuterik i Eagle M60 përdoret për të përfituar të dhënat e rrezeve X, krijimin e imazheve të rrezeve X, të shfaqë dhe procesojë imazhin nga database-it. Ai përdor programet në treg në dispozicion të Windows PC, që drejton software-in e inspektuesit të kontejnerëve të Rapiscan (Rapiscan Cargo Viewer). Monitorët me rezolucion të lartë, me ekran të sheshtë me ngjyra paraqesin imazhin me rreze X dhe kontrollet e kontejnerëve. Ekziston një njësi qendrore për ruajtjen e të dhënave dhe një pajisje për CD/DVD për ruajtjen e të dhënave. Imazhet shfaqen në ekranin e sheshtë me ngjyra dhe printohen në një printer me ngjyra.

Software-i i kompjuterit. Software-i i inspektuesit të kontejnerëve të Rapiscan (Rapiscan Cargo Viewer) i përdorur në Eagle M60 përfshin procesin e plotë të inspektimit të kontejnerëve, përfshirë dhe chek-in, skanimin dhe vlerësimin e imazhit. Inspektori përdor inspektuesin e kontejnerit për të shikuar, procesuar, vlerësuar dhe ruajtur imazhet me rreze X. Inspektuesi i kontejnerit përfshin një komplet të plotë të mjeteve të përpunimit të imazhit, përfshirë rregullimin e kontrastit dhe ndriçimit, zmadhimin/zvogëlimin, qartësimin e kufijve, filtrimin dhe funksionimin e histogramit. Tiparet për të cilat shfaqet interes mund të theksohen dhe të ruhen për referencë në të ardhmen.

1.3 Mënyra e skanimit

Mënyra Drive-by e skanimit nga kalimi i një apo më shumë objekteve bosh të palëvizshme nga Eagle M60 është me një shpejtësi prej 0.4 m/s në drejtimin para ose të kundërt. Ajo shtyhet nga një makineri skanimi dhe është e aftë për të rregulluar funksionimin me shpejtësi të ulët, e cila mundëson një skanim uniform dhe një imazh optimal. Eagle M60 skanon një automjet ose në mënyrë të vazhdueshme një numër automjesh.

1.4 Produkti (xhiroja)

Sipas mënyrës drive-by të skanimit, xhiroja maksimale e skanimit është 20 automjete për orë kur skanon një automjet në një herë dhe i gatshëm menjëherë për skanimin e automjeteve në radhë.

1.5 Imazhet

Ilustrimet e imazheve me rreze X të Eagle M60 paraqiten në figurat 4-5

1.5. Imazhet

Ilustrimet e imazheve me rreze X të Eagle M60 paraqiten në figurat 4-5.




Figura 4. Imazhi i Eagle M60 me ngjyra




Figura 5. Imazhi i Eagle M60 bardh e zi

1.6 Specifikimet e veprimtarisë së Eagle M60

Automjetet

Platforma	Mercedes Benz ose Mack truck që plotësojnë rregullat lokale rrugore
Lloji i automjetit	Kamionat me 3 akse (6x4)
Transmetimi	<ul style="list-style-type: none"> • Manual • Automatik (opsional)
Përmasat e përgjithshme – në vend	12 m gjatësi x 2.5 m gjerësi x 4.0 m gjatësi
Përmasat e përgjithshme – në gjendje pune	<ul style="list-style-type: none"> • 12 m gjatësi x 7.8 m gjerësi x 5.1 m gjatësi • 12 m gjatësi x 7.8 m gjerësi x 5.6 m gjatësi me tunel opsional inspektimi të zgjeruar
Përparësitë	<ul style="list-style-type: none"> • I plotësuar në tërësi përfshirë gjenerator të brendshëm - Funksionimi në kufij



Në gjendje pune

Pozicioni i dedektorit

Orientimi i dedektorit

Organizimi

Inspektimi

Gjeneratori me rreze X

Inspektimi i fushës së veprimit

Mënyra e skanimit

Mënyra e skanimit Drive-by

- Drejtimet e skanimit

- Shpejtësia e skanimit

- Energjia e rrezeve X

- Produkti (xhiroja)

Ekuipazhi

Ekspozimi ndaj rrezatimit

- Rrezatimi Gamma

Kryerja e imazhit

Thellësia e çelikut. mm

Shpërbërja në ajër. mm

Ndjeshmëria e kontrastit %

Shpërbërja hapësinore. mm

Ndarja e materialit

Thellësia e imazhit

Mjedisi

Temperatura

Lagështia

2. Ura Rapiscan Eagle G60

Në anën e pasagjerit

90° në drejtim të objektit të inspektuar

Më pak se 30 minuta në mjedisin standard të operimit

• 6 MV përshpejtues linear

• 6 MV përshpejtues linear me energji të dyfishtë për ndarjen e materialit

• 0.4 m në 4.6 m gjatësi x 2.8 m gjerësi x çdo gjatësi

• Drive-by

• Përpara ose në drejtim të kundërt

• 0.4 m/s

• 6 MV

• Deri në 20 kamionë për orë, e gatshme menjëherë për skanim

• Shoferi 1-2 inspektorë dhe drejtues në terren

• Inspektori i tretë opsional

RPM

290-330 mm në 6 MV

1 deri 6 MV

1% (1 mm çelik pas 100 mm çelik) në 6 MV

3 në 6 MV

Përshpejtues linear me energji të dyfishtë gjenerator me rreze X


20 bits me shfaqje 16 bit

• - 10°C deri +40°C

• - 40°C me paketa opsionale të motit të ftohtë

• +55°C me paketa opsionale të motit të ngrohtë

5% deri 95% të pakondensuara



2.1 Përmbledhje

Eagle Rapiscan® G60 "Eagle G60" është anëtar i Rapiscan Seria - G të sistemeve të kontrollit me energji të lartë me rreze X të urave të montuara me binarë për skanim të shpejtë, të automatizuar të automjeteve dhe kontejnerëve. Është i përshtatshëm më së miri për shqyrtimin (vëzhgimin) e ngarkesave në hyrje të objekteve kritike kryesore, si dhe vendkalimet kufitare dhe

portet. Gjeneratori me rreze X dhe vektori i dedektorit me rreze X janë të montuar në një vinç urë të ushqyer me energji elektrike që lëviz mbi binarë. Sistemi automatikisht skanon automjetet apo kontejnerë bosh të parkuar ndërmjet binarëve. Ura është e kontrolluar në distancë nga një zyrë në afërsi dhe imazhet me rreze X të nxjerra dërgohen në një zyrë aty pranë për shqyrtim dhe vlerësim.

Eagle G60 ka një sistem imazhi me rreze X-60MV që mundëson inspektim të ngarkesave të dendura, verifikim të identifikimeve të kontrabandës, eksplozivëve, armëve dhe narkotikëve.

Objekti Eagle G60 përbëhet nga një urë, e cila mbështet gjeneratorin dhe boshtin e dedektorit me rreze X, binarët dhe zyrat e kontejnerizuara.

G60 Eagle ka një kombinim të veçantë të karakteristikave:

- Një sistem imazhi me rreze X : 6MV. Sistemi i Eagle 60 6M me rreze X depërton dhe paraqet një imazh të ngarkesave të mbushura dhe të dendura, të cilat përndryshe do të duhet të inspektohen manualisht.

- Teknologjia e ndarjes së materialit nga Rapiscan Eagle G60 është i vetmi produkt i serisë G me teknologji të ndarjes me material opsional, që ndihmon inspektorin të gjejë kontrabandën me densitet të ulët, si për shembull eksplozivët dhe lëndët narkotike. Këto materiale me densitet të ulët shfaqen ndryshe në imazhet me rreze X nga materialet me densitet të lartë, si për shembull aftësia për të ndarë materialin ka nevojë për gjeneratorin opsional me dual-energji me rreze X 6 MV me Eagle G60.

Eagle G60 ofron inspektim-vëzhgimin me rreze X më të mirë të rangut të vet dhe karakteristika operative në një sistem inspektimi automjetesh dhe mallrash me binarë të urave.

- Skaneri i vinç-urës të montuar me binarë;
- Skanim të objekteve boshe të parkuara ndërmjet binarëve;
- Operim i skanimit i automatizuar i nivelit të lartë;
- Sistem vëzhgimi me rreze X-6MV;
- Cilësi imazhi me rreze X e përparuar;
- Program softueri Rapiscan Cargo Viewer (Rapiscan shikues mallrash) i lehtë për t'u përdorur;
- Plotëson standardet e sigurisë për rrezatimet;
- I lehtë për t'u mirëmbajtur.




Figura 1. Eagle G60




Fig. 2 Konfigurimi i imazhit nga rrezet X të Eagle G60

2.2 Objekti

Një skicë tipike e një objekti Eagle G60 që përfshin urën, binarët, zyrat dhe mure mbrojtëse opsionale është treguar në vizatim skematik paraqitur në figurën 3.

Paraqitja e objektit është optimizuar në përshatshmëri për vendin specifik dhe për gjërat e nevojshme për inspektim. Gjatësia e shinave përcakton gjatësinë e zonës së inspektimit dhe gjatësinë e një ose më shumë mjeteve që mund të kontrollohen njëkohësisht. Imazhet me rreze X dërgohen në zyrat e inspektimit për shqyrtim nga një inspektor. Nga atje, imazhet mund të transmetohen me anë të një rrjeti komunikimi (*Network*) te një objekt më i largët për vlerësim të mëtejshëm nga ana e inspektorëve të tjerë.




Figura 3. Objekti Eagle G60 with Optional Radiation Shielding Walls

Zona e detyrueshme e paprekur nga rrezatimi, që rrethon urën dhe shinat, mund të reduktohet duke përdorur mure mbrojtëse betoni opsional në të dyja anët e shinave, siç tregohet ë figurë. Vini re se muret janë në mënyrë tipike më të trashë prapa dedektorit me rreze X se prapa gjeneratorit me rreze X. Muret mund të hidhen në vend ose të ndërtohen nga panele betoni për t'u mundësuar atyre që të çmontohen dhe të vendosen në vende të ndryshme.

Njësia mund të instalohet brenda një ndërtese, që është e projektuar për të siguruar mbrojtje nga mjedisi dhe ruajtje nga rrezatimi. Muret mbrojtëse dhe një ndërtesë nuk janë pjesë e konfigurimit standard Eagle G60.

2.3 Sistemi i imazhit

Gjeneratori me rreze X. Eagle G60 përdor një përshpejtues linear 6 MV për të prodhuar një energji të lartë të rrezeve X. Gjeneratori me rreze X mbrohet plotësisht dhe rrezet paralele të grumbulluara në formën e një erashke, e cila minimizon dozën radioaktivitetin duke rritur ndërkohë intensitetin e rrezeve në qendrën e objektit që do të skanohet. Forma e erashkës orientohet në mënyrë të tillë që të inspektojë nga boshti në krye të një kamioni apo kontejneri pa qoshe të prera. Përshpejtuesi linear me energji të dyfishtë përdoret me aftësinë e ndarjes opsionale të materialit.

Sistemi i dedektorit. Sistemi i dedektorit të Eagle M60 përdor kristale të shkëlqyeshme të montuara në një diodë që transmeton rrezet X. Dedektorët dhe sistemi elektronik organizohen në module të formës së shkronjës L. Ky dizajn mundëson minimizimin e distancës nga gjeneratori të dedektorit të rrezeve X, ndërsa ende garanton inspektimin në 100% të një kamioni apo kontejneri. Mburoja e dedektorit mbron dedektorin nga degradimi mjedisor. Dyert mundësojnë akses të lehtë për modulet individuale të shërbimit. Produkti nga dedektorit dërgohet në sistemin elektronik të imazheve të Rapiscan dhe më pas te postacioni për analizën e imazheve për ekspozim.

Njësia qendrore e kompjuterit. Sistemi i kompjuterit i Eagle M60 përdoret për të përfutur të dhënat e rrezeve X, krijimin e imazheve të rrezeve X, të shfaqë dhe procesojë imazhin nga database-t. Ai përdor programet në dispozicion që janë në treg të Windows PC, të cilat drejtojnë software-in e inspektuesit të kontejnerëve të Rapiscan (Rapiscan Cargo Viewer). Monitorët me rezolucion të lartë, me ekran të sheshtë me ngjyra paraqesin imazhin me rreze X, kontrollet e kontejnerëve. Ekziston një njësi qendrore për ruajtjen e të dhënave dhe një pajisje për CD/DVD për ruajtjen e të dhënave. Imazhet shfaqen në ekranin e sheshtë me ngjyra dhe printohen në një printer me ngjyra.

Software-i i kompjuterit. Softwer-i i inspektuesit të kontejnerëve të Rapiscan (Rapiscan Cargo Viewer) i përdorur në Eagle M60 përfshin procesin e plotë të inspektimit të kontejnerëve, përfshirë check-in, skanimin dhe vlerësimin e imazhit. Inspektori përdor inspektuesin e kontejnerit për të shikuar, procesuar, vlerësuar dhe ruajtur imazhet me rreze X. Inspektuesi i kontejnerit përfshin një komplet të plotë të mjeteve të përpunimit të imazhit, përfshirë rregullimin e kontrastit dhe ndriçimit, zmadhimin, zvogëlimin, qartësimin e kufijve, filtrimin dhe funksionimin e histogramit. Tiparet për të cilat shfaqet interes, mund të theksohen dhe të ruhen për referencë në të ardhmen.

2.4 Mënyra e skanimit

Mënyra e skanimit nga kalimi i një apo më shumë objekteve bosh të palëvizshme nga Eagle M60 është me një shpejtësi prej 0.4 m/s në drejtimin para ose të kundërt. Ura nuk duhet të kthehet në pozicionin fillestar për të filluar skanimin në vijim.

2.5 Produkti (xhiroja)

Eagle G60 skanon me një xhiro maksimale skanimi prej 20 automjeteve për orë kur skanon një automjet në një herë dhe me një plotësim të menjëhershëm me automjete të gatshme për t'u skanuar.



2.6 Imazhet

Figurat 6-7 përfaqësojnë imazhet e inspektimit të kontejnerëve për Eagle G60




Figura 6. Imazhi përfaqësues i Egle G60 me ngjyra të rreme




Figura 7. Imazhi përfaqësues i Eagle G60 bardh e zi

2.7 Specifikimet e veprimtarisë së Eagle G60

Inspektimi

Gjeneratori me rreze X
Orientimi i dedektorit me rreze X
Inspektimi i fushës së veprimit

Mënyra e skanimit
Mënyra e skanimit drive-by:
- Drejtimet e skanimit
- Shpejtësia e skanimit
- Energjia e rrezeve X
- Produkti (xhiroja)
Ekspozimi ndaj rrezatimit

Rrezatimi Gamma
Ekuipazhi

Kryerja e imazhit

Thellësia e çelikut.mm
Shpërbërja në ajër.mm
Ndjeshmëria e kontrastit %
Shpërbërja hapësinore.mm
Ndarja e materialit

Thellësia e imazhit

Mjedisi

Temperatura

Lagështia

- 6 MV përshpejtues linear
- 90° në drejtim të objektit të inspektuar
- 0.4 m në 4.6 m gjatësi x 2.8 m gjerësi x çdo gjatësi
- Drive-by
- Përpara ose në drejtim të kundërt
- 0.4 m/s
- 6 MV
- Deri në 20 kamionë për orë, e gatshme menjëherë për skanim RPM

1-2 inspektorë dhe drejtues në terren, nëpunës i kontrollit

340 mm në 6 MV

1 deri 6 MV

1% (1 mm çelik pas 100 mm çelik) në 6 MV

3 mm diametër teli pas 100 mm çelik në 6 MV

Përshpejtues linear me energji të dyfishtë gjenerator me rreze X

20 bits me shfaqje 16 bit


- -10°C deri +40°C
- -40°C me paketa opsionale të motit të ftohtë
- +55°C me paketa opsionale të motit të ngrohtë
- 5% deri 95% të pakondensuara

3. Komponentët e Rapican Eagle

3.1 Zyrat

Zyrat janë ndërtuar për të siguruar një punë të rehatshme dhe të sigurt për punonjësit e tyre. Ato janë të pajisura me të gjitha benifitet, përfshirë rrjetin elektrik, ndriçimin (ngrohje, ventilimi dhe ajri i kondicionuar) dhe hapësirat e punës.

Figura 6 paraqet një mostër nga brenda Zyrës së inspektimit me një inspektor. Ajo tregon monitorët e kompjuterit për operimin, duke përfshirë imazhet CCTV, vlerësimin e imazheve, si dhe kontrollin dhe monitorimin. Gjithashtu, në foto shihen E-stop dhe mikrofoni altoparlant. Vendi i analizimit dhe i monitorimi të treguar në figurën 6 është i njëjtë për çdo inspektor shtesë.



Shembull I Zyrave



Shembull i zyrës së operimit nga brenda

3.2 Kontrolli i trafikut dhe sistemi monitorues

Kontrolli i trafikut dhe sistemi monitorues. Godina e Rapiscan Eagles përfshin një sistem të plotë të kontrollit të trafikut dhe monitorues (TCMS), i cili kontrollon dhe monitoron qarkullimin e automjeteve përmes hyrjes për të siguruar një operim sa më të sigurt. TCMS, ilustruar në figurën 7, përfshin tipikisht këto elemente të cilët mund të ndryshojnë në lloj, sasi ose vendndodhje në varësi të kërkesave specifike të aplikimit.

- Dritat e kontrollit të trafikut në hyrje për të sinjalizuar momentin e sigurt për të hyrë në objekt

- Sensorë të cilët gjejnë pozicionin e kamionit në objekt.


- Sensor shpejtësie për të matur shpejtësinë e automjetit, që përdoret për të rregulluar operimin e përshpejtuesit linear dhe për të minimizuar shtrembërimin e imazhit si pasojë e ndryshimeve të shpejtësisë.

- Shenjat mund të përdoren për të instruktuar shoferin për mbajtur shpejtësinë e duhur.



- Sensori i kontrollit të rrezeve që zbulon pjesën e përparme dhe të pasme të kamionit dhe fundin e kabinës së shoferit. Gjithashtu, përdoret për të ndezur dhe për të fikur gjeneratorin (gjeneratorët) me rreze X në kohën e duhur.

- Kamerat CCTV për monitorin e objektit dhe afërsinë e saj.



3.3 Sistemi elektrik

Sistemi elektrik Rapiscan Eagles është dizenuar për të operuar në kufij dhe për të shpërndarë këtë energji përmes sistemi në një mënyrë të sigurt sipas standardeve dhe rregulloreve të zbatueshme. Energjia lokale transformohet sipas nevojave për të siguruar që energjia në skaner është brenda tolerancave të lejuara. Rapiscan Eagle standard operon me një energji prej 400 VAC, 50 Hz, 32 anps/phase, 3-phase, e cila mbështet operimin e të gjithë sistemit të inspektimit. Komponentët e shërbimeve dhe të sistemit me energji të ulët operojnë me një fazë të vetme prej 220 V me tela neutral dhe të groposur. Në njësinë e Rapiscan Eagle është gjithashtu në dispozicion një gjenerator emergjence. Në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike për një kohë të shkurtër, gjeneratori do t'i japë energji të gjithë objektin e inspektimit të kontejnerëve.

3.4 Sistemi CCTV

Një sistem televiziv me qark të mbyllur (CCTV) i jep mundësi operatorit për të parë objektin e skanerëve të Rapiscan Eagle dhe zonës përreth. Katër kamera me ngjyra fikse janë vendosur në hyrje dhe dalje të objektit të skanerëve për të siguruar një mbulim të plotë të vendit. Sistemi CCTV ka një software të dedikuar për të drejtuar dhe kontrolluar sistemin.

Më poshtë jepet një shembull i komponentëve tipikë të Reapiscan Eagle CCTV.

- Kamera fikse CCTV-kamera komunikimi me akset 223 M IP me T92A00 të mbuluara që ofrojnë një mbrojtje të masës IP66 kundër pluhurit dhe shiut të fortë dhe siguron operimin që nga 20°C deri në 50°C.

- Kamera PTZ Kamera komunikimi me akset 232D+IP.

- Monitor me ngjyra-Dell UltraSharp 2009W 20inch monitor me ekran të sheshtë.

- Kamera kontrolli dhe ndërrimi të imazhit-Milestone X-Protect Pro në kompjutera Dell OptiPlex 780.

- Ruajtje e imazhit në CCTV-CCTV. Imazhet do të ruhen në kompjutera Dell OptiPlex 780 me një sistem qendror me përmasa ruajtjeje sipas kërkesave specifike.

Kamerat CCTV kontrollohen nga operatori, i cili i shikon imazhet në monitorë të sheshtë në pozicionin e operatorit. Operatori ka aftësinë të përdorë kamerat PTZ dhe të paraqesë imazhe nga një kamera ose disa kamera në një monitor. Imazhet regjistrohen në sistemin kompjuterik të CCTV.

3.5 Komunikimi

Sistemi Rapiscan Eagle është dizenuar të ofrojë komunikimin mes anëtarëve të ekuipazhit në objektin e inspektimit të kontejnerëve, përfshirë personelin në zyra dhe në çdo vend tjetër të objektit.

Pajisjet portative të komunikimit (*walkie talkies*) ruhen dhe mbahen në zyrën e inspektimit.

Dy pajisje Motorola model GP340 *walkie-talkie* dhe Motorola GM340 ose të ngjashme shpërndahen me njësinë Rapiscan Eagle.

Operatori në zyrën e inspektimit mund të përdorë gjithashtu sistemin e altoparlantit publik për komunikim të njëanshëm me objektin e skanerëve, në veçanti, altoparlantët në hyrjet dhe daljet mund të përdoren për të paralajmëruar personelin nëse janë parë të hyjnë në.

SHTOJCA B NIVELET E SHËRBIMEVE DHE ZBRITJET

Nivelet e shërbimit do të referohen nga dy njësi matëse kryesore: disponueshmëria e vendit dhe koha e shërbimit të përgjigjes. Funkzioni i tyre kryesor është për të matur nivelin e përbushjes së shërbimit të ofruar nga Rapiscan në përputhje me kontratën.

Mospërbushja e rezultateve të niveleve të shërbimit do të rezultojë në zbritje, të cilat janë përcaktuar me hollësi në këtë seksion.

Matja e disponueshmërisë së vendit

Objektivi kryesor i matjes të disponueshmërisë së vendit është përcaktimi i sasisë së kohës që vendi është funksional. Për të dhënë llogari për këtë matje, Rapiscan do të regjistrojë të gjitha “kohët jashtë shërbimit” (të planifikuara dhe paplanifikuara) të vendit mbi një bazë mujore. Një raport mujor i të gjitha “kohëve jashtë shërbimit” do të sigurohet për autoritetin.

Një vend konsiderohet i vlefshëm kur funksionet e gjenerimit të imazhit, analiza e imazhit, dhe shpërndarja e rezultateve të procesit të rishikimit, janë të gjitha funksionale.

Një vend konsiderohet i pavlefshëm kur ai nuk është në përputhje me funksionet e përcaktuara menjëherë në paragrafin e mësipërm. Pavlefshmëria fillon nga koha kur Rapiscan identifikon se ndonjë nga këto funksione nuk është funksional.

Pavlefshmëria nuk do të konsiderohet kundrejt Rapiscan kur një problem mund t’i atribuohet një force madhore, siç përcaktohet në kontratë, ose që i takon një pale të tretë, përveç nënkontraktorëve të Rapiscan ose ndërprerjeve të rëna dakord me autoritetin. Për këtë arsye, Rinacspan do t’i paraqesë Autoritetit, me shkrim, problemet që kanë vepruar kundër pavlefshmërisë dhe arsyet pse ato nuk duhet të konsiderohen shkak i zbritjes.

Vlefshmëria do të matet, vlerësohet dhe çdo zbritje do të aplikohet nga vendi:

Formula për të matur vlefshmërinë e çdo vendi, dhe nga cila do të llogaritet vlefshmëria e vendit, është si vijon:

$$\text{Site Availability} = \left[1 - \frac{(\text{THU} - \text{SMH})}{\text{WHPM}} \right] \cdot 100$$

ku:

THU = Orë totale të pavlefshme në muaj.

SMH = Orë të planifikuara të mirëmbajtjes në muaj.

WHPM = Numri i orëve të punës në muaj që vendi është planifikuar të jetë operativ. Kjo duhet të pasqyrojë ose standarde operative të përcaktuara për këtë vend.

Njësia matëse për matjen e disponueshmërisë së vendit është:

Emri	Matja	Dorëzimet	Koha e mbulimit
Vlefshmëria e vendit	93.7%	Raporti mujor i vendit Vlefshmëria për çdo vend	Orët e planifikuara të veprimt të një vendi

Duke filluar nga data e fillimit të veprimt të një vendi, Autoriteti do t’i japë Rapiscan një periudhë prej dy (2) muaj kalendarike (60 ditë kalendarike) në të cilën asnjë zbritje nuk do të aplikohet për shkelje të niveleve të shërbimit të disponueshmërisë për çdo vend të përkthyer në tabelën e mësipërme. Kjo periudhë kohore do të lejojë Rapiscan dhe autoritetin për të punuar me dhe për të koordinuar protokollat operacionale dhe të komunikimit.



Zbritja nga padisponueshmëria e vendit

Zbritjet për shkak të padisponueshmërisë do të aplikohen për secilin dhe çdo vend në veprim, ku disponueshmëria e vendit është më pak se vlefshmëria e mujore minimale e vendit (zbritja nga padisponueshmëria e vendit). Një zbritje e tillë do të llogaritet duke zbritur disponueshmërinë e vendit nga vlefshmëria mujore minimale e vendit dhe më pas duke zbritur këtë diferencë nga disponueshmëria minimale mujore e vendit. Ky koeficient do të shumëzohet me shumën e pagesës mujore në pajtim me seksionin 10.2.1 pjesëtuar me pesë.

Vetëm për qëllime shpjeguese supozimet e mëposhtme do të përdoren si shembull:

- Disponueshmëria e vendit = 85 %

- Shuma e pagesës mujore = 1.462.500 €

Llogaritja e shembullit:

Zbritja e padisponueshmërisë së vendeve = $(93.7\% - 85\%) / 93.7\% \times (\text{€ } 1,462,500 / 5)$
 $= 8.7\% / 93.7\% \times \text{€ } 292,500 = \text{€ } 27,158.48$

Matja e përgjigjes së shërbimit

Përgjigja e shërbimit konsiderohet e kënaqshme kur një inxhinier i RAPISCAN-it i kualifikuar në fushën e shërbimit arrin në vend në përgjigje të një ngjarje padisponueshmërie brenda kohës së caktuar, ose kur një incident është kthyer në normalitet nga RAPISCAN brenda kohës së caktuar.

Matja për “kohën e përgjigjes së shërbimit” është:

Tipi i dorëzimit të veçantë	Përshkrimi	Matja	Dorëzimet
Kujdes ndaj incidenteve dhe problemeve	Përgjigje e shërbimit ndaj njoftimit të padisponueshmërisë së vendit	Maksimum 3 përgjigje shërbimi	Raport mujor i kohës së përgjigjes së shërbimit për padisponueshmërinë e vendit

Penalitetet për vonesat në shërbim

Rapiscan do të jetë subjekt i penaliteteve si më poshtë:

1. Për çdo vonesë të reagimit në lidhje me mosfunksionimin e sistemeve G60 të vendosura në Durrës, në rastet kur njoftimi për jodisponueshmërinë tejkalon një (1) orë metrike përgjigje, Rapiscan do t'i vlerësohet një penalitet prej 3,000.00 euro për çdo vonesë.

2. Për çdo vonesë të reagimit në lidhje me mosfunksionimin e sistemeve të tjera G60, në rastet kur njoftimi për jodisponueshmërinë tejkalon dy (2) orë metrike përgjigje, Rapiscan do t'i vlerësohet në penalitet prej 3,000.00 euro për çdo orë vonesë.

3. Për çdo vonesë të reagimit në lidhje me mosfunksionimin e njërive të lëvizshme, në raste kur njoftimi për jodisponueshmërinë tejkalon tri (3) orë metrike përgjigje, Rapiscan do t'i vlerësohet një penalitet prej 375.00 euro për çdo orë vonesë.

4. Për çdo periudhë 30-ditore vonesë nga data e fillimit të operimeve për çdo vend (sipas shtojcës C “Plani kohor i zbatimit”) Rapiscan do t'i vlerësohet një penalitet prej 30,000.00 euro, me kusht që ky penalitet do të zbatohet vetëm për periudha të plota 30-ditore dhe Rapiscan nuk do të jetë përgjegjës për vonesat lidhur me datën e fillimit të operimeve të cilat janë më pak se 30 ditë.

5. Rapiscan do t'i vlerësohet një penalitet prej 30,000.00 euro për çdo analizë të dështuar të imazheve, në qoftë se nga shërbimi i skanimit të imazhit rezulton prania e kontrabandës dhe/ose anomali që janë haptazi dhe qartësisht të dukshme dhe kur veprimet e mëposhtme kanë ndodhur sipas radhës në vijim:

a) Rapiscan dështon në identifikimin dhe regjistrimin e një anomalie ose një kontrabande të tillë; dhe

b) Autoriteti bazuar në analizën e tij të mëpasshme për të njëjtin imazh identifikon praninë e kontrabandës dhe/ose një anomalie që është haptazi dhe qartësisht e dukshme; dhe

c) Një kontroll fizik i kryer më pas konfirmon praninë e kontrabandës dhe/ose një anomalie të tillë; dhe

d) Autoriteti dhe Rapiscan kanë, pasi kanë shkëmbyer informacionin e duhur të të dhënave dhe provat, konsiderojnë se penalitetet e përmendura më lart janë një masë e përshtatshme.

6. Pavarësisht pikës 5 më lart vlera e penaliteteve që do të vendosen sipas pikës 5 më lart, do të vlerësohet vetëm për periudha rishikimi të plota dhe nuk do të jetë më e madhe se 300,000.00 (dyqind mijë) euro për çdo periudhë rishikimi. Për qëllim të kësaj shtojce “Periudhë rishikimi” nënkupton periudhat e njëpasnjëshme prej 12 muaj të plotë, duke filluar 6 muaj pas datës në të cilën të gjitha vendet kanë filluar operimin,

7. Nëse në një periudhë rishikimi të caktuar, numri i penaliteteve që vendosen sipas pikës 5 më lart për shkak të një analize të dështuar të imazhit është më i madh se 2% e numrit total të skanimeve të kryera në atë periudhë rishikimi, autoriteti do të njoftojë Rapiscan dhe nëse përqindja e analizave të dështuara të imazheve për tre muajt që pasojnë këtë periudhë rishikimi vazhdon që të jetë jo më e vogël se 2%, atëherë autoriteti rezervon të drejtën për zgjidhjen e parakohshme të kësaj kontrate.

Zgjidhja e zbritjeve

Totali i penaliteteve për shkak të padisponueshmërisë së vendit për një muaj të caktuar do të zbritet nga pagesa e muajit vijues në përputhje me seksionin 10.1. Totali i penaliteteve si më sipër nga pika 5 deri në pikën 76 do të llogaritet për çdo periudhë rishikimi dhe do të zbritet nga pagesat që bëhen të kërkueshme pas periudhës përkatëse të rishikimit.

ANEKSI C

Tabela e projektit	Kohëzgjatja
Data efektive e Kontratës	0 ditë
Themelimi i degës së Rapiscan	30 ditë
Përcaktimi i vendeve nga dogana shqiptare	45 ditë
Kryerja e inspektimeve të vendeve nga Rapiscan	15 ditë
Përfundimi i dizenjimit të vendeve nga Rapiscan	15 ditë
Marrjet e lejeve të ndërtimit nga dogana shqiptare dhe Rapiscan	60 ditë
Marrja e lejes për aksesin në energjinë elektrike nga dogana dhe Rapiscan	60 ditë
Vendi 1 punimet civile	105 ditë
Instalimi i pajisjeve nga Rapiscan në vendin 1	20 ditë
Rapiscan fillon me testimin dhe certifikimin e vendit 1	15 ditë
Rapiscan fillon me trajnimin e operatorëve në vendin 1	20 ditë
Rapiscan paraqet interpretimin e imazhit për doganën shqiptare	20 ditë
Rapiscan fillon me operimet në vendin 1	244 ditë
Katër (4) vende për punimet civile site civil works	120 ditë
Rapiscan instalon pajisjet në katër (4) vende	30 ditë
Rapiscan fillon sistemin e testimit dhe certifikimit në katër (4) vendet	30 ditë



Rapiscan fillon me trajnimin e operatorëve në katër (4) vendet	
Rapiscan paraqet interpretimin e imazhit për doganën shqiptare	30 ditë
Rapiscan fillon punimet në katër (4) vende	365 ditë

SHTOJCA D

Përmbajtja e kësaj shtojce përbën tërësinë e propozimit të Rapiscan paraqitur pranë Ministrisë së Financave në datën 15.11.2012, si dhe dokumenteve standarde të kësaj procedure konkurruese.

SHTOJCA (E) PROCESI I INSPEKTIMIT

Ky dokument paraqet një model të procesit të inspektimit dhe analizimin e imazheve të prodhuara nga teknologjia me rreze X jo-ndërhyrëse për transport mallrash dhe/ose mjeteve të lehta. Kapjen e imazheve, cikli i informacionit, organizimi i burimeve, si dhe procedurat e përfshira në këtë proces janë identifikuar në mënyrë të qartë.

1. Procesi punës

1.1 Hyrja dhe skanimi

1. Automjeti hyn në korsinë e inspektimit, më pas automjeti drejtohet në korsinë e inspektimit jo ndërhyrës me shpejtësi 8 deri në 12 km/h.

a) Sistemi jo ndërhyrës i inspektimit krijon një imazh të skanimit dhe e paraqet atë përmes sistemit të analizës së imazhimit dhe më pas e dërgon atë në server-in e sistemit.

b) Automjeti do të riskanohet nëse:

- mungon imazhi i skanuar i inspektimit jo ndërhyrës;
- imazhi i papranueshëm i nënsistemit të inspektimit.

Imazhi i nënsistemit të inspektimit është i papranueshëm nëse:

- ndodh një avari që errëson qoftë edhe pjesërisht imazhin e automjetit.

1.2 Inspektimi i imazhit

- Staf i Rapiscan screening do të kryejë inspektimin fillestar të imazhit dhe të vlerësojë nëse ekziston ndonjë parregullsi. "Parregullsi" do të thotë çdo pjesë e një imazhi që është lehtësisht e identifikueshëm me sy, duke përdorur standardet e vendosura në trajnimin e operatorit, siç të mëposhtmet: a) narkotiket; b) armët e zjarrit; c) përmbajtje të imazhit të papërputhshme me faturën e ngarkesës e aplikuar/e dorëzuar; dhe d) përmbajtje të imazhit të tjera të dyshimta sipas standardeve të përcaktuara në trajnimin e operatorit.

- Çdo parregullsi imazhi do të raportohet menjëherë tek autoritetet e identifikuara si autoriteti.

a) Ngarkesat dhe automjetet e përcjella për inspektim dytësor sipas gjykimit në diskrecion të vetëm të Autoritetit apo të personelit shtesë qeveritar të paracaktuar, pas shqyrtimit të imazhit dhe dokumentacionit.

b) Pas referimit tek Autoriteti, çdo veprim shtesë në lidhje me automjetin e dyshuar, do të drejtohet nga ato autoritete apo përforcime shtesë të ligjshme.

c) Çdo automjet i dyshimtë i përcjellë për inspektim dytësor duhet të largohet nga zona e skanimit për të lejuar kështu vazhdimin e operacionit të skanimit.

1.3 Dalja

- nëse nuk identifikohen parregullsi gjatë rishikimit të imazhit dhe të dhënave përkatëse të automjetit, ky i fundit është i lirë të procedojë në zonën e inspektimit.

- të dhënat e inspektimit të imazhit janë në server-in e database-it.
- veprimi përkatës është i gatshëm për rishikimin e imazhit nga inspektorët e Autoritetit.

VENDIM
Nr. 26/2013

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR DHE CAKTIMIN E OBJEKTIT, PËRBËRJES
DHE AFATIT TË VEPRIMTARISË SË TIJ PËR HETIMIN E FAKTEVE, RRETHANAVE
DHE PËRGJEGJËSIVE TË INCIDENTIT TË DATËS 24 PRILL 2013 PRANË AKADEMISË
DIPLOMATIKE TË VJENËS**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891 datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”, si dhe të neneve 25 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e fakteve, rrethanave dhe përgjegjësi të incidentit të datës 24 prill 2013 pranë Akademisë Diplomatike të Vjenës.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

a) hetimi për zbardhjen e plotë të fakteve dhe rrethanave të incidentit të datës 24 prill 2013 pranë Akademisë Diplomatike të Vjenës;

b) hetimi i plotë i veprimeve dhe përgjegjësi të individëve të përfshirë në incidentin e datës 24 prill 2013 pranë Akademisë Diplomatike të Vjenës;

c) në vartësi të rezultateve të hetimit, të përpunojë rekomandime Kuvendit të Shqipërisë për rivendosjen e dinjitetit të shtetit shqiptar.

III. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 9 deputetë. Kryetari i përket Partisë Demokratike. Përbërja e komisionit është si më poshtë:

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Fatbardh Kadilli | Kryetar (PD) |
| 2. | Zëvendëskryetar(PS) |
| 3. Paulina Hoti | Anëtar |
| 4. Osman Metalla | “ |
| 5. Gert Bogdani | “ |
| 6. Luçiano Boçi | “ |
| 7. | “ |
| 8. | “ |
| 9. | “ |

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 1-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 29.4.2013



VENDIM
Nr. 27/2013

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT
ARTAN BROCI ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8123, datë 26.4.2013,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënie e pëlqimit për emërimin e zotit Artan Broci anëtar i Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 29.4.2013

VENDIM
Nr. 28/2013

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI DHE KRYETARIT TË KËSHILLIT
DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61 pika 6 të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Pirro Xhixho lirohet nga detyra e anëtarit dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 2.5.2013

VENDIM
Nr. 29/2013

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61 pika 6 të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Alketa Mukavelati lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 2.5.2013

VENDIM
Nr. 30/2013

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61 pika 6 të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Benon Paloka lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 2.5.2013



VENDIM
Nr. 31/2013

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61 pika 6 të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Zamira Nurçe lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratur në datën 2.5.2013

VENDIM
Nr. 32/2013

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 61 pika 6 të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Alban Karapici lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratur në datën 2.5.2013

VENDIM
Nr. 33/2013

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114 pika 3 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të nenit 61 pika 6 të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Alketa Mukavelati zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare me mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 2.5.2013

VENDIM
Nr. 34/2013

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114 pika 3 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të nenit 61 pika 6 të ligjit nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Benon Paloka zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me mandat 4-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 2.5.2013

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 10.5.2013
Doli nga shtypi më 10.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë